# LNOB - HARTËZIMI SOCIAL

## *"Askush të mos mbetet pas"*

## Bashkia Lushnjë

**Autor: Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim"**

**MAJ 2022**

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

In cooperation with
NALAS

**Raport mbi Hartëzimin Social LNOB në Bashkinë Lushnjë**

Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Raporti i Rezultateve të Hartëzimit Social:
Hartëzimi Social për identifikimin e nevojave për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara në bashkinë Lushnjë

**Bashkia Lushnjë / Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim"**
**Esmeralda Hoxha**
**Arbana Dibra**

**Maj 2022**

**MIRËNJOHJE**

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) shpreh mirënjohjen e saj për njerëzit që u përfshinë dhe kontribuan në Hartëzimin Social për Bashkinë Lushnjë. Falenderojmë prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara, përfaqësuesit e institucioneve vendore që u bashkuan dhe na dhanë informacion në lidhje me situatën e këtij target grupi në vend dhe familjet e 126 fëmijëve me aftësi të kufizuara në Lushnjë, të cilat hapën dyert e shtëpive të tyre dhe së bashku diskutuam dhe evidentuam situatën reale të fëmijëve të tyre.

GADC dëshiron të falenderojë kryetaren e Bashkisë Lushnjë, znj. Eriselda Sefa, për gatishmërinë dhe disponueshmërinë për të bashkëpunuar për këtë hartëzim social shumë të rëndësishëm; Znj. Joreta Sinjari nga Bashkia Lushnjë e cila së bashku me stafin e GADC koordinuan punën në terren për këtë studim dhe znj. Keti Daja nga Shoqata e Pushtetit Vendor. Një falenderim i veçantë shkon për 15 anketuesit e përkushtuar që punuan pa u lodhur për të kryer intervistat me prindërit/kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Dëshirojmë gjithashtu që të falënderojmë kolegët e Center for Research and Policy Making Consulting Maqedonia e Veriut, të cilët kanë udhëhequr Hartëzimin Social dhe kanë hartuar metodologjinë e procesit.

Puna për përgatitjen e këtij raporti mbështetet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH si edhe Network of Associations of Local Authorities of South East Europe. Raporti bazohet në gjetjet e hartëzimit social të realizuar në Bashkinë Lushnjë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e GIZ GmbH.

## *Tabela e Përmbajtjes*

**1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE ..... 5**
**2. GRUPI I SYNUAR PËR HARTËZIMIN SOCIAL ..... 7**

2.1. SHPJEGIMI SE PSE POPULLATA E SYNUAR I PËRKET GRUPIT LNOB ..... 8
2.2. PËRMBLEDHJE E KONSULTIMEVE ME ZYRTARËT E BASHKISË DHE PALËT E TJERA TË INTERESIT ..... 9
2.3. PËRMBLEDHJE E ANALIZËS SË TË DHËNAVE DYTËSORE ..... 11

**3. INFORMACION I SHKURTËR PËR BASHKINË LUSHNJË DHE POLITIKAT NË NIVEL VENDOR ..... 13**
**4. OBJEKTIVAT E HARTËZIMIT SOCIAL ..... 14**
**5. METODOLOGJIA ..... 16**
**6. REZULTATET E HARTËZIMIT SOCIAL ..... 17**
**7. ANALIZA E GJEO-ETIKETIMIT TË BURIMEVE SOCIO-EKONOMIKE NË DISPOZICION ..... 18**

7.1. GJEO-ETIKETIMI I PIKAVE KRITIKE PËR FËMIJËT DHE TË RRITURIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA ..... 19
7.2. GRUPI LNOB– FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA ..... 21
7.3. STATUSI SOCIO-EKONOMIK ..... 23

*7.3.1. Punësimi demografik ..... 23*
*7.3.2. Të ardhurat ..... 24*
*7.3.3. Kushtet e jetesës ..... 26*

7.4. GJEOGRAFIA – FAKTOR RISKU ..... 30

*7.4.1. Rreziku dhe risku i izolimit për shkak të kushteve të jetesës ..... 30*
*7.4.2. Vlerësimi i nevojave për fëmijët me aftësi të kufizuara ..... 32*

7.4.2.1. Vlerësimi i nevojave bazuar në gjendjen shëndetësore ..... 32
7.4.2.2. Vlerësimi i nevojave për shërbim në shtëpi ..... 36
7.4.2.3. Vlerësimi i nevojave për shërbime sociale në komunitetin lokal ..... 41

7.5. VLERËSIMI I SHËRBIMEVE DHE INSTITUCIONEVE ARSIMORE ..... 47
7.6. QEVERISJA – FAKTOR RISKU ..... 49

*7.6.1. Vlerësimi i pikëpamjeve dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara ..... 49*

7.7. DISKRIMINIMI – FAKTOR RISKU ..... 51

*7.7.1. Vlerësimi i përballjes me diskriminimin ..... 51*
*7.7.2. Cenueshmëria – faktor risku – pandemia COVID 19 ..... 52*

**8. ANALIZIMI I FOKUS GRUPEVE – FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA ..... 54**
**9. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME ..... 58**
**10. REKOMANDIME NË PËRPUTHJE ME OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM (OZHQ) ..... 60**

## 1. Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport shqyrton situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara në bashkinë Lushnjë nëpërmjet metodologjisë së Hartëzimit Social. Qëllimi kryesor i hartëzimit social është të kontribuojë në dokumentimin e nevojave për shërbime sociale dhe shëndetësore që fëmijët me aftësi të kufizuara kanë në bashkinë e Lushnjës. Duke ofruar shërbimet e duhura, përpjekjet synojnë forcimin e kohezionit social në nivel vendor duke forcuar përfshirjen sociale dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) 2021-2025[1], po drejton politikat kombëtare si një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika kushtuar personave me aftësi të kufizuara që do të zbatohen gjatë 5 viteve të ardhshme. Bashkitë, sipas Ligjit 139/2015, për Vetëqeverisjen Vendore[2], kanë juridiksion në fushën e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, të cilat janë të detyruara të ndërmarrin masa për sigurimin e mbrojtjes sociale për personat në nevojë. Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale në nivel vendor për personat me aftësi të kufizuara, nënat beqare, gratë e dhunuara, viktimat e trafikut, të moshuarit sipas përcaktimit në ligj, ndërtimin dhe administrimin e shtëpive sociale, qendrave, për ofrimin e shërbimeve sociale vendore, krijimin në bashkëpunim me ministritë e linjës përgjegjëse për mirëqenien sociale të fondit social për financimin e shërbimeve në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Megjithatë, bashkitë kanë nevojë për ndihmë për të kapërcyer vështirësitë në realizimin e një ushtrimi të hartëzimit social për një grup të caktuar dhe të synuar. Hartëzimi Social do t'i hapë rrugën stafit të Bashkisë për të aplikuar këtë metodologji për grupet e tjera të synuara në të ardhmen dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Axhenda 2030 dhe 17 synimet e saj zhvillimore, dhe veçanërisht principin gjithëpërfshirës "Askush të mos mbetet pas" (LNOB) parim i cili në fakt gëzon pak vëmendje nga autoritetet përkatëse shtetërore dhe po ecën me ngadalësi.

**Gjetjet kryesore:**

- Nga 187 fëmijë me aftësi të kufizuara, 118 prej tyre jetojnë në njësi administrative rurale dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre në fshatra me shumë pak shtëpi ku numri i banorëve nuk i kalon 100. Është pikërisht kjo kategori që jeton në zona të thella, e cila ka mungesat më të shumta për sa i përket spitaleve apo shërbimeve të tjera.
- Më shumë se 50% e familjeve të këtij target grupi varen nga ndihma sociale për shkak të paaftësisë së fëmijëve të tyre dhe në pothuajse 99% të rasteve njëri nga prindërit nuk punon sepse prindi kujdeset për fëmijën dhe zakonisht prindi kujdestar është nëna.
- 70% e të anketuarve jetojnë me pagë nën mesatare.

[1] **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 2021**. *Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.* Online: https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/333
[2] **Qendra e Botimeve Zyrtare**. *Ligji Nr. 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore*. Online: https://qbz.gov.al/share/KJE20lswSs6DI_qmEC9geA

- Sipas fokus grupeve me prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara, kjo kategori shpesh diskriminohet në spitale, në transportin publik, në shkollë apo edhe në shoqëri.
- Pandemia e COVID-19 ka prekur fizikisht dhe mendërisht këtë kategori. Frika nga përkeqësimi i shëndetit të fëmijëve, izolimi, mungesa e financave e ka përkeqësuar situatën në këto familje.
- Në bashkinë e Lushnjës ekziston vetëm një qendër për fëmijët me aftësi të kufizuara, e quajtur Qendra e Zhvillimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo është një qendër ditore e cila ofron shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara të grupmoshave të ndryshme nga 2 deri në 16 vjeç dhe funksionon pesë ditë në javë nga e hëna në të premte.
- Vetëm 8% e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të regjistruar në zyrën e punës, ndërkohë që shkalla e papunësisë është mjaft e lartë për këta prindër.
- Fëmijët e identifikuar përballen me probleme të shumta në mësim, për shkak të mungesës së mësuesve ndihmës profesionistë.
- Mungon logjistika e duhur për transportin publik.
- Ka mungesë të shërbimeve të patronazhimit.
- Nga 44 shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në të gjithë bashkinë e Lushnjës, vetëm 16 prej tyre ofrojnë logjistikë bazë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Dhe, kjo logjistikë ka të bëjë vetëm me ndërtimin e rampave.
- Mungojnë shërbimet në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht për ata fëmijë që jetojnë në zona të thella rurale.
- Bashkia e Lushnjës ka hartuar Planin Social 2021 - 2023 por aktualisht nuk është zbatuar ende, për mungesë buxheti.
- 60% e të anketuarve jetojnë me të ardhura nën pagën minimale ligjore.
- 13.5% e të anketuarve kanë vuajtur nga uria disa herë (2-3 herë).
- 77.8% e shtëpive të të anketuarve i plotësojnë kushtet bazë të jetesës, ndërsa 7.1% e të anketuarve nuk i plotësojnë kushtet bazë të jetesës.
- 81.7% e shtëpive të të anketuarve nuk kanë aksesin e duhur për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Në 43,7% të rasteve është nëna ajo që e ndihmon fëmijën në aktivitetet e përditshme.
- 53.2% e të anketuarve janë shprehur se fëmija i tyre ka nevojë për kujdes në shtëpi dhe se do të donin që dikush ta vizitonte.
- Shumica e të anketuarve (60.3%) gjatë Hartëzimit Social kanë pohuar se fëmija i tyre nuk merr shërbimin e asistencës personale.
- Në bashki nuk ka klube që ofrojnë shoqërim, argëtim dhe rekreacion për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Në bashkinë e Lushnjës nuk ka asnjë institucion që ofron kujdes dhe mbështetje profesionale për ushqim, veshmbathje dhe kujdes shëndetësor nëse një fëmijë nuk ka kushtet për një jetë të pavarur.
- Bashkia nuk ka një numër telefoni SOS, por ka shpërndarë numrat personalë të specialistëve dhe punonjësve të Shërbimit Social apo Qendrës së Zhvillimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Bashkia Lushnjë nuk ofron transport të organizuar për këtë target grup, apo kompensim financiar dhe shumë prindër shpesh anashkalojnë vizitat mjekësore të fëmijëve.
- Shumë prindër kishin shumë pak informacion në lidhje me shërbimet e ofruara në bashkinë e Lushnjës për fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara.

- Gjatë periudhës së COVID-19, fëmijët me aftësi të kufizuara nuk morën ndihmë financiare shtesë nga shteti, por pako ushqimore nga bashkia.
- Shumë prindër me fëmijë të grupmoshës 0-6 vjeç nuk mund t'i çojnë fëmijët e tyre në çerdhe apo kopsht sepse ligji nuk parashikon mësues apo edukatorë mbështetës dhe për këtë arsye ata janë të detyruar t'i mbajnë në shtëpi.

## 2. Grupi i synuar për Hartëzimin Social

Gjatë përgatitjes së koncept notës, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) ka organizuar disa takime dhe intervista koordinuese me përfaqësues të bashkisë Lushnjë, si dhe ka bërë hulumtime në rrjet, ka rishikuar Planin Social [3] të kësaj bashkie, zërat buxhetorë, problematikat e ngritura dhe mungesën e shërbimeve. U rishikua Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025 dhe në bazë të të dhënave paraprake dhe problematikave vendore dhe kombëtare u vendos që ky hartëzim social të kryhet për ***fëmijët me aftësi të kufizuara në këtë bashki.***

Qëllimi i këtij Hartëzimi Social është të përmirësojë jetën dhe cilësinë e shërbimeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në bashkinë Lushnjë, për të çuar në ndryshime strategjike dhe praktike drejt gjithëpërfshirjes. Gjithashtu, për të forcuar shërbimet e ofruesve si dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara që të marrin mbështetjen e nevojshme nga mjedisi i tyre familjar/komunitar ose/dhe bashkia për të ndjekur rregullisht shkollën (pa braktisje të hershme!).

Sipas të dhënave paraprake në bashkinë e Lushnjës numërohen 187 fëmijë me aftësi të kufizuara nga të cilët 87 vajza dhe 100 djem.

Bashkia e Lushnjës nuk ka pasur mundësinë financiare dhe njerëzore për të kryer këtë lloj studimi në thellësi, ndaj ky studim është një domosdoshmëri për të përmirësuar çështjet e mëposhtme:

- Mungesa e infrastrukturës për fëmijët me aftësi të kufizuara në disa institucione.
- Mungesa e transportit për në shkollë, hapësira dhe vendi për të pasur aksesin e duhur në objektet shkollore.
- Mjetet e transportit nuk i plotësojnë nevojat logjistike të këtij grupi të synuar.
- Qendra PAK ofron shërbime deri në moshën 16 vjeçare, duke krijuar problem mungesën e shërbimeve për grupin e synuar mbi 16+.
- Mungesa e mësuesve mbështetës është një problem i ngritur nga shumë prindër, duke bërë që shumë fëmijë të mos ndjekin shkollën ose të mbeten shumë prapa në mësime.
- Mungesa e mjeteve të nevojshme në shkollë për kategori të ndryshme fëmijësh me aftësi të kufizuara.
- Diskriminimi – këta fëmijë përballen çdo ditë me ofendime, mospranim në ambiente të përbashkëta, mospërfshirje në aktivitete të ndryshme etj.
- Mungesa e shërbimit shëndetësor të specializuar.

[3] Plani Social Vendor – Bashkia Lushnjë 2021-2023

- Të ardhura ekonomike mjaft të ulëta të familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara, ndonjëherë deri në kufirin e varfërisë.

## 2.1. Shpjegimi se pse popullata e synuar i përket grupit LNOB

Sipas një studimi kombëtar[4], evidentohet se fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara në vend përballen me diskriminim, vështirësi ekonomike dhe arsimore dhe mungesë të shërbimeve të nevojshme. Problemet kryesore të identifikuara nga studimet e sipërpërmendura janë:

- Pakënaqësia me kushtet infrastrukturore të institucioneve arsimore dhe largësia e tyre;
- Pakënaqësia me përparimin e fëmijës në shkollë, niveli i përshtatjes së mësimdhënies si dhe niveli i respektit të treguar nga stafi arsimor;
- Shpenzimet e nevojshme të papërballueshme që mundësojnë ndjekjen e fëmijëve në institucionet arsimore etj.
- Diskriminim i lartë;
- Nënvlerësim i gjerë i aftësive dhe potencialit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Mungesa e njohurive të prindërve/kujdestarit ligjor se si mund të përfitojnë nga skema sociale.

Zotimi për të mos lënë askënd pas është një angazhim për t'i dhënë fund varfërisë ekstreme në të gjitha format e saj dhe për të vepruar në mënyrë eksplicite për të siguruar që ata që kanë mbetur pas mund të arrijnë ata që kanë përjetuar përparim më të madh. Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre janë duke luftuar jo vetëm për shkak të aftësive të kufizuara, por edhe për një jetë jashtë varfërisë, mungesës së një jete sociale dhe për mbështetje nga komuniteti.

**LNOB - faktori gjeografik**: Nga 187 fëmijë me aftësi të kufizuara, sipas të dhënave paraprake, 118 prej tyre jetojnë në njësi administrative rurale dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre në fshatra me shumë pak shtëpi ku numri i banorëve nuk i kalon 100. Është pikërisht kjo kategori që jeton në zona të thella, të cilët kanë mungesat më të mëdha për sa i përket spitaleve apo shërbimeve të tjera.

**LNOB - faktori i statusit socio-ekonomik:** Ndërsa gjendja ekonomike e familjeve të këtij target grupi është nën nivelin mesatar për një jetesë të denjë, sipas intervistave paraprake, më shumë se 50% e këtyre familjeve jetojnë me asistencë sociale për shkak të aftësisë së kufizuar, pagesa PAK të fëmijëve të tyre dhe në pothuajse 99% të rasteve njëri nga prindërit nuk punon sepse prindi kujdeset për fëmijën dhe zakonisht prindi kujdestar është nëna. Duke u kujdesur për fëmijët, nënat nuk kanë mundësi të punojnë, nuk kanë mundësi dhe kohë për veten e tyre

[4] World Vision dhe Save the Children.2018. *Aftësia e kufizuar tek fëmijët në Shqipëri: Përhapja e aftësisë së kufizuar, aksesi në shërbime dhe cilësia e shërbimeve.*Online: https://www.wvi.org/sites/default/files/PV%20FINAL_ALB.pdf

dhe janë në dispozicion të fëmijëve 24/7. Gjithashtu, nga 187 familje që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, vetëm 50 prej tyre marrin ndihmë financiare nga shteti si asistente personale.

**LNOB – faktori i diskriminimit:** Sipas fokus grupeve me prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara, kjo kategori shpesh diskriminohet, në spitale, në transportin publik, në shkollë apo edhe në shoqëri. Duke qenë se shërbimet e specializuara në spitale mungojnë për lloje të ndryshme aftësish të kufizuara, prindërit shpesh përballen me sjellje diskriminuese nga personeli mjekësor që i ndjek pa shumë shpjegime. Mungesa e logjistikës së duhur të transportit publik, përballja e prindërve me vështirësi dhe diskriminim nga pasagjerët ose shoferët.

**LNOB - faktori i cenueshmërisë:** Pandemia e COVID-19 ka prekur fizikisht dhe mendërisht këtë kategori. Frika nga përkeqësimi i shëndetit të fëmijëve, izolimi, mungesa e financave e ka përkeqësuar situatën në këto familje. Një aspekt tjetër që i rëndon këto familje janë përmbytjet natyrore që ndodhin në këto zona dhe si pasojë shkaktojnë dëme në të mbjellat e këtyre familjeve, të cilat në shumë raste janë burimi i parë financiar i tyre.

**LNOB - faktori qeverisës:** Prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk takohen rregullisht me njëri-tjetrin. Janë të pakta rastet kur ata marrin pjesë në dëgjesat publike të organizuara nga bashkia e Lushnjës edhe në rastet kur bëhet fjalë për interesat e këtij target grupi. Në shumë raste ata nuk kanë as informacion për takimet që organizohen apo për çfarë diskutohet.

Bashkitë, sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore, kanë juridiksion në fushën e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, dhe duhet të ndërmarrin masa për sigurimin e mbrojtjes sociale për personat e cenueshëm. Gjithashtu bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e mbrojtjes sociale, shërbimet në nivel vendor për personat me aftësi të kufizuara, nënat beqare, gratë e dhunuara, viktimat e trafikut, të moshuarit në mënyrën e përcaktuar me ligj, ndërtimin dhe administrimin e shtëpive sociale, qendrave, për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Si edhe krijimin në bashkëpunim me Ministritë e linjës përgjegjëse për mirëqenien sociale të fondit social për financimin e shërbimeve në mënyrën e përcaktuar me ligj. Megjithatë, bashkitë kanë nevojë për ndihmë për të kapërcyer vështirësitë në realizimin e një ushtrimi të hartëzimit social për një grup të synuar. Hartëzimi social që u realizua gjatë zbatimit të këtij projekti do t'i hapë rrugën stafit të Bashkisë për ta aplikuar këtë metodologji për grupet e tjera të synuara në të ardhmen dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Agjenda 2030 dhe 17 synimet e saj zhvillimore, dhe veçanërisht principi gjithëpërfshirës "Askush të mos mbetet pas" (LNOB), i cili në fakt gëzon pak vëmendje nga autoritetet përkatëse shtetërore dhe po përparon me ngadalësi. Hartëzimi Social do ta ndihmojë këtë bashki në analizimin e situatës, për plane sociale më të thelluara me buxhete përkatëse, të cilat për rrjedhojë do të çojnë në një qeverisje më të mirë për këtë target grup.

## 2.2. Përmbledhje e konsultimeve me zyrtarët e bashkisë dhe palët e tjera të interesit

GADC ka organizuar disa takime dhe intervista të thelluara me përfaqësues të bashkisë së Lushnjës, ku u konkludua se fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre përjetojnë

vazhdimisht pengesa për gëzimin e të drejtave të tyre themelore njerëzore dhe për përfshirjen e tyre në shoqëri.

Bashkia e Lushnjës ofron asistencë për aftësinë e kufizuar të vendosur nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë e cila paguhet për fëmijët me aftësi të kufizuara nëpërmjet një fondi të kushtëzuar të Qeverisë së Shqipërisë dhe bashkia administron shpërndarjen e tij. Pagesa që marrin këto familje është mjaft e ulët dhe shpesh nuk mjafton për të përballuar shpenzimet për ilaçet apo shërbimet e tjera të specializuara që nuk ofrohen në Lushnjë.

Në bashkinë e Lushnjës ka vetëm një qendër për fëmijët me aftësi të kufizuara (Qendra e Zhvillimit për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara – Qendra e PAK). Kjo është një qendër ditore e cila ofron shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara të grupmoshave të ndryshme nga 2 deri në 16 vjeç dhe funksionon pesë ditë në javë nga e hëna në të premte. Funksioni i së cilës është parashikuar në buxhetin e Bashkisë Lushnjë me një fond total prej 14.366.000 lekë/vit. Në këtë qendër punojnë 4 psikologë, 2 fizioterapistë, 2 logopedë, 2 specialistë të pedagogjisë speciale si dhe stafi mbështetës.

Supozimi është se pas analizës social-ekonomike, bashkia e Lushnjës do të rishikojë buxhetet për shërbimet e specializuara brenda territorit të saj dhe qeveria do të rishikojë pagesën mujore për këtë kategori.
Sipas takimeve dhe fokus grupeve të zhvilluara, vetëm 8% e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të regjistruar në zyrën e punës, ndërkohë që shkalla e papunësisë është mjaft e lartë për këta prindër.

Fëmijët e identifikuar përballen gjithashtu me probleme të shumta në mësim, për shkak të mungesës së mësuesve ndihmës profesionistë, mungesës së transportit të duhur, mungesës së shërbimeve bazë në nivel vendor. Familjet kanë të ardhura të ulëta ekonomike dhe si rrjedhojë nuk mund të marrin shërbime për fëmijët jashtë bashkisë së Lushnjës. Prindërit e këtyre fëmijëve duhet të kujdesen në mënyrë të vazhdueshme për ta pasi mungojnë shërbimet e patronazhimit, duke rezultuar në të ardhura ekonomike shumë të ulëta në familje.
Bashkia Lushnjë nuk ka mundësi të tjera për të evidentuar problemet dhe Hartëzimi Social i nxjerrë nga ky studim do ta orientojë atë për të identifikuar problemet dhe për të përcaktuar prioritetet dhe planet e tyre sociale apo të përgjithshme, duke i shoqëruar me buxhetet përkatëse.

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë një kategori shumë e ndjeshme, vulnerabël dhe kanë nevojë për shumë vëmendje. Gjithashtu, kjo kategori ka qenë më pak e përfshirë në shërbimet sociale për shkak të pagesës që marrin nga buxheti i shtetit lidhur me aftësinë e kufizuar. Kjo kategori duhet të mbështetet në vazhdimësi me shërbime të këshillimit psikologjik dhe në natyrë si: ushqim, veshmbathje, ilaçe, logjistikë etj.

**Për shkak të bashkëpunimit të ngushtë me bashkinë e Lushnjës, u përshkruan supozimet dhe perceptimet fillestare të mëposhtme:**

- Stafi i Bashkisë Lushnjë është i gatshëm të bashkëpunojë dhe të marrë njohuritë, megjithatë rreziku që këta persona të transferohen në drejtori apo institucione të tjera është i lartë.
- Vazhdimësi e bashkëpunimit të mirë dhe interesimi nga Bashkia Lushnjë për të bërë ndryshime domethënëse për personat me aftësi të kufizuar.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe do të informojnë sinqerisht gjatë diskutimeve në fokus grupe dhe gjatë intervistave ballë për ballë.
- Zyrtarët e caktuar për të bashkëpunuar me GADC do të ndryshojnë qëndrimin e tyre dhe do të ndërveprojnë pas aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve.
- Hartëzimi social është i suksesshëm dhe çon në ndryshime të veprimeve strategjike dhe praktike drejt përfshirjes.

### 2.3. Përmbledhje e analizës së të dhënave dytësore

Sipas të dhënave zyrtare të bashkisë së Lushnjës, në vitin 2021 buxheti total për ndihmën financiare për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe ndihmësit e tyre ishte 24,533,244 lekë. Nga 187 familje, vetëm 50 prej tyre përfitojnë ndihmë PAK si kujdestarë.

Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Aftësisë për Punë për Personat me Aftësi të Kufizuara (KMCAPI) është një organ mjekësor dhe juridik që e mbështet veprimtarinë e tij në dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "*Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë*" dhe për kriteret mjekësore të përcaktimit të aftësisë për punë të të sëmurëve dhe të invalidëve. Ai përcakton shkallën e humbjes së aftësisë për punë të invalidit dhe rrugët që duhen ndjekur për rehabilitimin e tij fizik dhe profesional. Kur personi me aftësi të kufizuara, në këtë rast fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili me vendim të këtij komisioni mjekësor është përcaktuar se ka nevojë për kujdes, atëherë dhe vetëm atëherë merr ndihmë financiare mujore edhe për kujdestarin e tyre. Kjo varet nga kategoria që i caktohet secilit prej fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ky komision. Shumica e fëmijëve me aftësi të kufizuara në këtë bashki janë kategorizuar në kategorinë e parë që nuk përfshin pagesat PAK për kujdestarët.

Nëse analizojmë pagesën mujore për secilin prej fëmijëve, ajo është mesatarisht 11.000 lekë në muaj, shumë e cila në rastin e bashkive që nuk kanë shumë shërbime për këtë kategori, është mjaft e ulët dhe nevoja për mbështetje më të madhe qoftë financiare, në natyrë apo me shërbime të specializuara është mjaft e lartë.

Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të detyruar të qëndrojnë në shtëpi dhe të ofrojnë kujdes për ta, pasi mungojnë qendrat e duhura ditore apo rezidenciale, mungojnë shërbimet e patronazhimit etj. Për këtë arsye, të ardhurat ekonomike mujore në këto familje janë mjaft të ulëta, në rastet më të mira ata kanë si të ardhur mujore një rrogë nga njëri prind që punon dhe në rastet e tjera janë familje të cilat mbështeten vetëm në ndihmën PAK që marrin për fëmijën. Sipas intervistave me përfaqësues të Zyrës Lokale të Punës, numri i prindërve të këtyre fëmijëve që aplikojnë për punë është relativisht i ulët.
Nga 44 shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në të gjithë bashkinë e Lushnjës, vetëm 16 prej tyre ofrojnë logjistikë bazë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Dhe, kjo logjistikë ka të bëjë vetëm

me ndërtimin e rampave dhe vetëm një shkollë e mesme në qytetin e Lushnjës është e pajisur me ashensor.

Sipas ligjit 69/2012[5] të ndryshuar "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", neni 64 përcakton se:

- Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Ministrit të Shëndetësisë, **ofron edukim arsimor në shtëpi** për nxënësit që nuk mund të ndjekin një shkollë të rregullt ose të specializuar të arsimit bazë.

Por ky nuk është rasti i fëmijëve me aftësi të kufizuara në bashkinë e Lushnjës. Sipas të dhënave të analizuara, ky target grup në shkollë ndihmohet nga mësuesit mbështetës gjatë orëve të mësimit në shkolla me të gjithë fëmijët e tjerë. Zakonisht qëndrojnë 2 orë në mëngjes dhe 2 orë pasdite sipas rastit dhe rezultatet janë mjaft të ulëta në nxënien e njohurive nga fëmijët. Në zonat rurale, më larg qytetit, nuk ka mësues të tillë, ose nuk janë të përhershëm dhe shpesh mungon prania e tyre në klasat ku ka fëmijë me aftësi të kufizuara. Ligji i mësipërm nuk parashikon mësues mbështetës për fëmijët që ndjekin çerdhe ose kopshte (0-6 vjeç), dhe ky fakt është theksuar edhe gjatë intervistave apo fokus grupeve të organizuara pranë kësaj bashkie.

Gjatë intervistave, fokus grupeve por edhe gjatë analizës së anketës, një mangësi tjetër është infrastruktura mjedisore e cila është mjaft e varfër dhe ka nevojë për përmirësim, veçanërisht në zonat rurale. Stafi i specializuar sipas nevojave specifike të rasteve që trajtohen në të vetmen qendër të bashkisë nuk është i mjaftueshëm dhe numri i fëmijëve të trajtuar nga kjo qendër është mjaft i ulët në krahasim me numrin e përgjithshëm të tyre në të gjithë bashkinë.

Mungojnë shërbimet në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht ata që jetojnë në zona të thella rurale (*sipas detyrimeve që rrjedhin nga ligji për shërbimet në shtëpi për grupet vulnerabël, dhjetor 2016*)

Sipas intervistave dhe kontrollit të fakteve në terren, në të gjithë bashkinë e Lushnjës mungon logjistika e duhur e transportit për këtë kategori, qoftë ai publik apo privat. Gjithashtu bashkia e Lushnjës nuk mbulon shpenzimet e transportit në rastet kur fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të udhëtojnë për të marrë shërbimet e nevojshme. Sipas intervistave në bashkinë e Lushnjës, për transportin urban, personat me aftësi të kufizuar përfitojnë një fond prej 1.600.000 lekësh/vit. Ky fond për vitin 2021 u përdor 100% për transportin e personave me aftësi të kufizuar në lidhje me përdorimin pa pagesë të transportit publik, pasi ata janë pajisur me libreza të aftësisë së kufizuar të cilat sigurohen në momentin e marrjes së diagnozës. Por, sipas intervistave dhe fokus grupeve me prindër apo kujdestarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, asnjëri prej tyre nuk ka përfituar nga ky fond. Supozohet se ky fond përdoret për të

[5] Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ligji nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"* i përditësuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Online https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/Permbledhje-parauniversitari-8-Tetor-2020.pdf

rriturit me aftësi të kufizuara, për përdorimin e transportit publik pa pagesë, duke përdorur dokumentin e aftësisë së kufizuar.

Kryqi i Kuq – Dega Lushnjë, ofron asistencë dhe mbështetje me pako ushqimore dhe veshmbathje për familjet e varfra dhe në nevojë, përfshirë edhe familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Zakonisht shpërndarja e këtyre pakove bëhet një herë në vit dhe përmbajtja e tyre është paketa bazë ushqimore për një familje me 4-5 persona, për 1 muaj. Tre vite më parë, me iniciativë të Kryqit të Kuq u dërguan lodra për zhvillimin mendor në Qendrën e Zhvillimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, por që atëherë nuk ka pasur buxhet për të dërguar të tjera. Në shkurt 2021, Kryqi i Kuq shpërndau çeqe me vlerë 100$ për 30 familje në nevojë në bashkinë e Lushnjës, ku 2 prej tyre ishin familje të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

## 3. Informacion i shkurtër për Bashkinë Lushnjë dhe politikat në nivel vendor

**Zona Gjeografike**: Pas reformës territoriale të Republikës së Shqipërisë në vitin 2015, bashkia e re e Lushnjës kufizohet në veri me bashkitë Rrogozhinë dhe Peqin, në lindje me bashkinë Belsh, në jug me bashkitë Fier dhe Roskovec dhe në perëndim nga bashkia e Divjakës. Qendra e bashkisë së re është qyteti i Lushnjës.
Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 85 fshatra. Sipërfaqja e bashkisë së re është 372.72 km$^2$. Lushnja është zona më e rëndësishme bujqësore e Shqipërisë me kultura, perime, pjepër dhe produkte blegtorale në ultësira, si dhe ullinj dhe vreshta në zonat kodrinore. Lushnja është e ndarë në 10 njësi administrative dhe 5 lagje, nga të cilat 10 janë rurale dhe 5 lagje në zona urbane.

**Popullsia**: Bashkia e Lushnjës, sipas Institutit të Statistikave të Censusit të vitit 2011, ka një popullsi rezidente prej 83,659 banorësh, ndërsa Regjistri Civil tregon një popullsi prej 127,438 banorësh. Sipas regjistrimit, dendësia e popullsisë është 244.7 banorë për km$^2$, ndërsa sipas gjendjes civile dendësia është 341.91 banorë për km$^2$. Sipas statistikave të fillimit të vitit 2017, pjesa më e madhe e popullsisë së kësaj bashkie jeton në zonat rurale, 63% e saj.

**Shëndeti**: Funksioni ligjor i njësive të qeverisjes vendore shtrihet vetëm në mirëmbajtjen e infrastrukturës së shërbimit të kujdesit parësor. Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier është institucioni kryesor që mbulon këtë zonë në Bashkinë Lushnjë. Aktualisht nga kjo drejtori ofrohen këto shërbime: 1. Shërbimi Epidemiologjik, 2. Shërbimi Shëndetësor Mjekësor, 3. Shërbimi i Mjekësisë Familjare, 4. Shërbimi Stomatologjik, 5. Shërbimi Psiko-Social dhe Shëndetësor Mendor.

**Shërbimi Social**: Në kuadër të ligjit nr. 139/2015 për vetëqeverisjen vendore ngarkohet Bashkia Lushnjë, si dhe njësitë e tjera të qeverisjes vendore, me një gamë të gjerë përgjegjësish dhe kompetencash në fushën e shërbimeve të kujdesit social. Shërbimet e kujdesit social përfshijnë ofrimin e shërbimeve sociale në komunitet, rishikimin dhe vendimmarrjen në lidhje me procedurat e kujdestarisë; si dhe menaxhimin e shërbimeve rezidenciale në raste të veçanta. Legjislacioni përcakton gjithashtu detyrime specifike për

shërbimin social në nivel vendor, duke përfshirë ngritjen e pikave fokale gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve.

**Programi i Shërbimit Social** siguron mbrojtje sociale për grupet në nevojë, të ofruara nëpërmjet pagesave në para të ndihmës ekonomike dhe për personat me aftësi të kufizuara. Kjo pjesë e programit financohet plotësisht; nga ana tjetër, Bashkia planifikon çdo vit një fond për grupet në nevojë që për arsye të caktuara nuk përfitojnë nga skema qendrore e ndihmës ekonomike, por që Bashkia e gjykon të nevojshme për ti mbështetur financiarisht jashtë kësaj skeme; për vitin 2021 fondi që Bashkia Lushnjë ka miratuar nga buxheti i saj për kujdesin social është 34,626,440 lekë.

Programi i Shërbimit Social ofron edhe strehim social me një fond i cili përbëhet nga shpenzimet e planifikuara operative me një total prej 4,000,000 lekësh, shpenzimet e pritshme për marrjen me qira të vendit për të moshuarit janë një fond prej 920,000 lekësh, ndërsa për transportin publik për personat me aftësi të kufizuara është i parashikuar fondi prej 1,600,000 lekësh.

**Buxheti** i bashkisë Lushnjë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre ishte 24,533,244 lekë për vitin 2021. Ky buxhet përfshin pagesat mujore që marrin fëmijët me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre. Ndërkohë që në bashkinë e Lushnjës në vitin 2021 janë trajtuar me ndihmë ekonomike vetëm 2 fëmijë me aftësi të kufizuara.

Ka shumë probleme që hasin kategori të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ndër këto probleme për fëmijët e verbër nënvizohet mungesa e sinjaleve zanore në ambientet publike, duke e vështirësuar lëvizjen, frekuentimin e këtyre hapësirave apo institucioneve etj. dhe për rrjedhojë edhe izolimin e tyre nga shoqëria. Gjithashtu, problemi kryesor për fëmijët me aftësi tetraplegjike është mungesa e infrastrukturës adekuate në shkolla, qendra shëndetësore dhe hapësira publike. Bashkia e Lushnjës ka hartuar Planin Social 2021 - 2023 por aktualisht nuk është zbatuar ende, për mungesë buxheti. Kjo është edhe arsyeja që në shumicën e rasteve Planet Sociale hartohen por mbeten në letër dhe nuk zbatohen pikërisht për mungesë fondesh dhe specifikim të zërave në buxhetin bashkiak.

## 4. Objektivat e Hartëzimit Social

Objektivi i përgjithshëm i Hartëzimit Social është të kontribuojë në përfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Lushnjës, përmirësimin e cilësisë së jetës si dhe nxitjen e kohezionit social në nivel vendor duke promovuar lokalizimin e Axhendës 2030 dhe objektivat e saj, në veçanti parimin “Askush të mos mbetet pas” – LNOB në nivel bashkie.

**Rezultati i pritshëm:** Përmirësimi i jetës dhe cilësisë së shërbimeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Bashkinë Lushnjë.

- Hartëzimi social është i suksesshme dhe çon në ndryshime në veprimet strategjike dhe praktike drejt gjithpërfshirjes.
- Ofruesit e shërbimeve forcojnë shërbimet e tyre për fëmijët me aftësi të kufizuara.

- Fëmijët me aftësi të kufizuara marrin mbështetjen e nevojshme nga mjedisi i tyre familjar/komunitar dhe bashkia për të ndjekur rregullisht shkollën (pa braktisje të hershme!)

Hartëzimi Social me kontribut në parimet LNOB dhe direktivën për bashkinë Lushnjë për përmbushjen e Objektivave specifike të Zhvillimit të Qëndrueshëm, për:

a) Shëndet dhe mirëqenie të mirë;
b) Arsimim gjithëpërfshirës dhe cilësor;
c) Reduktimi i pabarazive;
d) Qytete dhe komunitete të qëndrueshme.

**Pyetjet e hulumtimit dhe përmbledhje e gjetjeve:**

- **Gjendja socio-ekonomike e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre?**

Familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë probleme të mëdha socio-ekonomike si pasojë e papunësisë. Pagesa PAK që familjet marrin për aftësinë e kufizuar përdoret më shumë për ushqim, dhe jo për shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara. 50% e prindërve të intervistuar jetojnë me pagesën PAK për shkak të aftësisë së kufizuar të fëmijës dhe vetëm 5.6% e tyre gëzojnë të drejtën e ndihmës financiare nga shteti si kujdestarë personal. Ilaçet (disa prej tyre nuk rimbursohen) kushtojnë shumë dhe shërbimet që mungojnë në bashkinë e Lushnjës i detyrojnë këto familje të shpenzojnë si për transport ashtu edhe për shërbimin e marrë në një qytet tjetër.

Janë 29.4% e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët kanë deklaruar se në 12 muajt e fundit janë përballur disa herë me mungesën e financave për të blerë ushqime për familjen dhe 38% e tyre nuk kanë mundur të përballojnë ilaçet.

- **Cili është niveli i të ardhurave të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara?**

60% e të anketuarve për këtë anketim social kishin të ardhura nga 10,000-30,000 lekë.

- **Si janë kushtet e jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuara?**

Nga prindërit e intervistuar dhe verifikimi i fakteve në banesat përkatëse, 12.7% e këtyre familjeve nuk kishin pajisje hidraulike të brendshme, 19% e tyre nuk kishin banjë dhe dush të instaluar brenda shtëpisë dhe 22% e tyre nuk kishin kuzhinë në shtëpi.

- **Cili është niveli i rrezikshmërisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara?**

Niveli i rrezikshmërisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara është i lartë, në përshtatjen e shtëpisë me një logjistikë të përshtatshme për lëvizjen e tyre. Duke pasur një situatë ekonomike nën mesatare, familjet e këtyre fëmijëve e kanë të pamundur të krijojnë një mjedis miqësor për fëmijët e tyre. Gjithashtu, logjistika mungon në institucione të ndryshme publike. Shpesh për shkak të largësisë nga qendrat ku ofrohen shërbimet, prindërit anashkalojnë

vizitat e tyre mjekësore, duke çuar kështu në përkeqësim të shëndetit. Pandemia e COVID-19 ka rritur më tej rrezikun e përkeqësimit të shëndetit të këtij grupi të synuar. Gjithashtu mbështetja e psikologëve nuk është në nivelet më të mira, sidomos për sa i përket frekuencës. Si fëmijët ashtu edhe prindërit e tyre kanë nevojë për një mbështetje të tillë, por për këta të fundit (prindërit) duket se ky është shërbimi i fundit që ata mendojnë për veten e tyre.

- **Cilat janë nevojat për shërbime sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara? Cila është gjendja e përgjithshme e fëmijëve me aftësi të kufizuara?**

Fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht në zonat rurale, vuajnë nga mungesa e shërbimeve sociale ose mjekësore, për shkak të distancës së tyre. Mungesa e informacionit nga prindërit, si dhe të ardhurat financiare shpesh sjellin pasoja në përkeqësimin e shëndetit të fëmijëve.

- **Çfarë kushtesh dhe qendrash sociale, si dhe burime njerëzore ofrohen nga bashkia?**

Në bashkinë e Lushnjës ka një qendër për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo është një qendër ditore e cila ofron shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara të grupmoshave të ndryshme nga 2 deri në 16 vjeç dhe funksionon pesë ditë në javë nga e hëna në të premte. Funksioni i së cilës është parashikuar në buxhetin e Bashkisë Lushnjë me një fond total prej 14,366,00 lekësh. Në këtë qendër punojnë 4 psikologë, 2 fizioterapistë, 2 logopedë, 2 specialistë të pedagogjisë speciale si dhe personeli ndihmës.

- **Cilat janë veprimet afatshkurtra dhe afatgjata që mund të ndërmarrë bashkia për të trajtuar problemet?**

Nëpërmjet hartëzimit social do të informohet situata e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe do të planifikohen politika më të mira të mbrojtjes sociale nga bashkia e Lushnjës.

## 5. Metodologjia

Hartëzimi Social në bashkinë e Lushnjës u realizua në periudhën dhjetor 2021 - prill 2022, duke synuar grupin e paracaktuar të fëmijëve me aftësi të kufizuara në këtë bashki duke përdorur modalitetin e anketimit ballë për ballë.

Metodat e realizimit të hartëzimit social të fëmijëve me aftësi të kufizuara në bashkinë Lushnjë.

- **Sondazh në terren**: Në 15 njësi administrative të bashkisë Lushnjë janë realizuar 126 intervista me prindër/kujdestarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara. 15 anketues u trajnuan në trajnim njëditor në bazë të pyetësorit të dhënë, të përkthyer në gjuhën shqipe. Pyetësorët u plotësuan në kohë reale gjatë intervistave në platformën LimeSurvey
- **Diskutime në fokus grupe:** Pas përfundimit të anketës në terren, u zhvilluan 5 Diskutime në Fokus Grupe, përkatësisht: 4 me prindërit/kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe 1 FGD me palët e interesuara pranë kësaj bashkie. Diskutimi në fokus grup u drejtua nga një pyetësor gjysëm i strukturuar.

- **Intervista të thelluara**: Për realizimin e Hartëzimit Social janë realizuar 6 intervista të thelluara në bashkinë Lushnjë. Është realizuar 1 intervistë me një përfaqësues të organizatës së shoqërisë civile, e cila operon në të gjithë Shqipërinë, përfshirë Lushnjën dhe e cila ka në fokus fëmijët dhe familjet që jetojnë në kushte të vështira ekonomike, përfshirë familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara; është realizuar 1 intervistë me punonjës social në Qendrën e Zhvillimit për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara; 1 intervistë me përgjegjësin e sektorit të Shërbimit Social në bashkinë Lushnjë; 1 me përfaqësues të Shëndetit Publik në Lushnjë; 1 me përfaqësues të Kryqit të Kuq.
- **Modeli**: Kampionimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në Bashkinë Lushnjë është bazuar në të dhënat zyrtare të bashkisë. Gjithsej 187 fëmijë me aftësi të kufizuara. Ne kemi përdorur metodën e kampionimit të targetuar, duke realizuar 126 pyetësorë në 15 njësi administrative.
- **Pyetësori**: Gjatë Hartëzimit Social në Bashkinë Lushnjë, pyetësori i përdorur ishte i detajuar dhe disa rregullime u bënë në bazë të legjislacionit kombëtar si dhe nevojave lokale, në total 125 pyetje.
- **Lista e indikatorëve**: 1. Satusi Socio-ekonomik – faktor risku; 2. Gjeografia – faktor risku; 3. Vlerësimi i nevojave për fëmijët me aftësi të kufizuara (Vlerësimi i nevojave bazuar në gjendjen shëndetësore; Vlerësimi i nevojave për shërbim në shtëpi; Vlerësimi i nevojave për shërbime sociale në komunitetin lokal; Vlerësimi i shërbimeve dhe objekteve arsimore) 4. Qeverisja – faktor risku; 5. Diskriminimi – faktor risku; 6. Cenueshmëria ndaj goditjeve të paparashikuara – faktor risku – Pandemia COVID 19.
- **Testi Pilot**. Në bashkinë Lushnjë janë realizuar 5 intervista testuese. Sipas monitorimit në terren, koha mesatare për të kryer intervistën ishte 45 minuta. Pyetësori është rishikuar gjatë trajnimit dhe nuk ka pasur probleme.
- **Shkalla e përgjigjeve**: Të 126 prindërit/kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara iu përgjigjën 100% të pyetjeve të përfshira në pyetësor.
- **Programi i përpunimit dhe përgatitjes së të dhënave**: LimeSurvey dhe SPSS
- **Metodat e analizës së të dhënave:** Statistika përshkruese
- **Kufizimet**: Asnjë

## 6. Rezultatet e Hartëzimit Social

Ky kapitull bazohet në gjetjet e marra në kuadër të aktiviteteve kërkimore të kryera në territorin e Bashkisë Lushnjë. Rezultatet janë paraqitur për fëmijët me aftësi të kufizuara sipas strukturës së anketimit. Çdo pyetësor ishte i përbërë nga disa kapituj që synonin të shqyrtonin rreziqet dhe cenueshmërinë në përputhje me faktorët LNOB. Pyetësori përbëhej nga 126 pyetje të ndara në kategori si faktorë rreziku si më poshtë:

- Statusi Socio-Ekonomik
- Gjeografia
- Vlerësimi i nevojave për fëmijët me aftësi të kufizuara
- Qeverisja
- Diskriminimi
- Cenueshmëria ndaj goditjeve të paparashikuara

Gjetjet kryesore për secilin grup LNOB shpjegohen në detaje me të dhënat përkatëse të paraqitura në shpjegimin e grafikëve në kapitullin 7.

## 7. Analiza e gjeo-etiketimit të burimeve socio-ekonomike në dispozicion

Bashkia e Lushnjës nuk ka arritur ende të krijojë apo të mbështesë shërbime të natyrës rezidenciale, për asnjë nga kategoritë apo grupet në nevojë, si të moshuarit, fëmijët, gratë e dhunuara etj. Kjo është një mangësi mjaft e theksuar dhe ngritja e një qendre rezidenciale nënvizohet shpesh si prioritet gjatë procesit të vlerësimit që i parapriu hartimit të planit social. Krijimi i një shërbimi rezidencial për fëmijët konsiderohet i rëndësishëm veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në bashkinë e Lushnjës ka vetëm një qendër ditore që ofron shërbime për këtë target grup. **Qendra e zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara** ndodhet në territorin e bashkisë Lushnjë, pranë spitalit "Isan Cabej".

Qendra është ndërtuar nga UNDP dhe trajton fëmijë të moshave të ndryshme nga 0 deri në 16 vjeç. Kapaciteti i qendrës është për 24 fëmijë ndërsa aktualisht shërbime marrin 54 fëmijë. Qendra është ditore dhe ofron edhe dy krevate për rastet kur prindërit e fëmijëve kanë nevoja urgjente për të lënë fëmijët, por jo më shumë se dy netë. Në këtë qendër ofrohen shërbimet: terapi zhvillimore; terapi e të folurit; fizioterapi; terapi këshillimore me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara; dhe lojëra, muzikë ose terapi në grup. Mungojnë shërbimet për 16-18 vjeç me aftësi të kufizuara.

Funksioni ligjor i njësive të qeverisjes vendore shtrihet vetëm në mirëmbajtjen e infrastrukturës së shërbimit të kujdesit parësor. Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier është institucioni kryesor që mbulon këtë zonë në Bashkinë Lushnjë. Aktualisht nga kjo drejtori ofrohen këto shërbime: 1. Shërbimi Epidemiologjik, 2. Shërbimi Shëndetësor Mjekësor, 3. Shërbimi i Mjekësisë Familjare, 4. Shërbimi Stomatologjik, 5. Shërbimi Psiko-Social dhe Shëndetësor Mendor. Shërbimet e ofruara në qendrat shëndetësore në Lushnjë janë bazë dhe nuk ka shërbime të specializuara mjekësore për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në bashkinë e Lushnjës nuk ka transport të organizuar për kategoritë e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, asnjë nga mjetet e transportit publik apo privat nuk ofron logjistikën e nevojshme për këtë kategori.

Nga 44 shkolla që funksionojnë në territorin e bashkisë Lushnjë, vetëm 16 prej tyre kanë rampa për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vetëm 1 shkollë e mesme në qytet ofron edhe ashensor. Ndërsa sipas ligjit në fuqi, çdo shkollë fillore, 9-vjeçare dhe e mesme duhet të ketë mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbimi mungon në kopshte dhe çerdhe. Në Lushnjë e vetmja organizatë që ofron asistencë për këtë kategori është Shoqata Kombëtare në mbështetje të grupeve vulnerabël, e cila në anëtarësinë e saj ka edhe familje të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe i ndihmon me pako ushqimore periodikisht një herë në muaj.

Institucionet me akses për fëmijët me aftësi të kufizuara ku ka rampa të ndërtuara ose në disa raste ashensorë janë: Bashkia; Spitali i Lushnjës; Zyra e aplikimit për pasaporta; Poliklinika (Ambulanca) dhe Urgjenca.

**Kryqi i Kuq – Dega Lushnjë**, ofron asistencë dhe mbështetje me pako ushqimore dhe veshmbathje për familjet e varfra dhe në nevojë, përfshirë edhe familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Zakonisht shpërndarja e këtyre pakove bëhet një herë në vit dhe përmbajtja e tyre është paketa bazë ushqimore për një familje me 4-5 persona, për 1 muaj.

Harta e Institucioneve Publike, Shkollave dhe Qendrave Shëndetësore. https://bit.ly/3a2JsoM

### 7.1. Gjeo-etiketimi i pikave kritike për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara

Në bashkinë e Lushnjës, megjithëse janë bërë ndërhyrje, ka ende probleme në përshtatjen e logjistikës së duhur për aksesin në institucione të ndryshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, si për shembull Zyra Arsimore e kësaj bashkie, Qendra Kulturore, Biblioteka apo Muzeu, Posta, Qendrat Shëndetësore nr. 1 dhe nr. 2 në qytetin e Lushnjës.

Ndërsa godina e Bashkisë; Poliklinika Qendrore e qytetit; Zyra e aplikimit për pasaportë; Gjykata dhe Spitali kanë ndërtuar rampa dhe në spital ka edhe ashensor.




Në bashkinë e Lushnjës ka vetëm një organizatë joqeveritare që ndonjëherë ofron mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara. Përveç kësaj, të vetmet institucione që ofrojnë shërbime janë: Bashkia Lushnjë; Qendra e Zhvillimit, në varësi të bashkisë, poliklinikat (shërbimet bazë) dhe spitali.

Për sa i përket ambienteve logjistike të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në të 15 njësitë administrative të bashkisë Lushnjë, situata varion nga njësia rurale në atë urbane. Nga 44 shkollat në bashkinë e Lushnjës, vetëm 16 prej tyre janë të pajisura me hyrje dhe rampa të veçanta, ndërsa ***28 prej tyre nuk ofrojnë asnjë lehtësim logjistik për këtë target grup***.

***Në 10 qendrat shëndetësore të njësive administrative mungojnë hyrjet e veçanta dhe rampat e posaçme për fëmijët me aftësi të kufizuara.***

Zyra Arsimore dhe Qendra Kulturore e Bashkisë Lushnjë nuk ka hyrje apo rampa të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Biblioteka, Muzeu dhe Posta nuk kanë hyrje apo rampa të posaçme për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Departamenti i Shëndetit Publik dhe Qendra Shëndetësore nr. 2 nuk kanë hyrje të posaçme apo rampa për fëmijët me aftësi të kufizuara.

**Modele të shkollave që nuk kanë rampa ose/dhe ashensorë**

*Njësia Administrative Bubullimë* *Njësia Administrative Hysgjokaj*

**Modelet e Qendrave Shëndetësore në zonat rurale pa rampa dhe/ose ashensor**



*Njësia Administrative Dushk* *Njësia Administrative Golem*

## 7.2. Grupi LNOB– Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë përgjithësisht të përjashtuar, por veçanërisht fëmijët dhe familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara në zonat rurale vuajnë më shumë nga ky përjashtim. Kjo, nga mungesa e shërbimeve mjekësore në qendrat rezidenciale e deri te diskriminimi në institucione të ndryshme.
Informacioni i pamjaftueshëm që kanë këto familje; mungesa e njohurive të ligjit për fëmijët me aftësi të kufizuara; Distanca nga qendrat urbane dhe spitalet e specializuara janë disa nga arsyet që i bëjnë këto familje të mbeten më pas.
Në pjesën e analizës së Hartëzimit Social gjenden në detaje problemet kryesore që dalin nga fokus grupet, intervistat e thelluara dhe anketa të cilat nxjerrin në pah situatën aktuale të këtij target grupi.

**LNOB – faktori gjeografik**
Janë 13.5% e të anketuarve që jetojnë në zona të izoluara me më pak se 100 banorë, duke e bërë më të vështirë marrjen e informacionit edhe nga familjarët.

**LNOB - faktori socio-ekonomik:**
70% e të anketuarve jetojnë me pagë nën mesataren. Rreth 57% e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara nuk kanë një kompjuter në shtëpi për të ndihmuar fëmijët e tyre që të integrohen. Dhe nga familjet e tjera që kanë një pajisje të tillë nuk kanë internet në masën 40% edhe pse do të donin ta kishin. 20.6% e banesave të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk i plotësojnë kushtet minimale të jetesës ose i plotësojnë ato pjesërisht. 81.7% e të gjitha banesave të familjeve të këtyre fëmijëve nuk plotësojnë kushtet e duhura logjistike dhe nuk kanë aksesin e duhur për karriget me rrota. Vetëm 18% e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjithë bashkinë e Lushnjës janë të punësuar.

**LNOB – faktori diskriminues:** Sipas këtij studimi, kjo kategori shpesh diskriminohet, në spitale, në transportin publik, në shkollë apo edhe në shoqëri. Duke qenë se shërbimet e specializuara në spitale mungojnë për lloje të ndryshme aftësish të kufizuara, prindërit shpesh përballen me sjellje diskriminuese nga personeli mjekësor që i ndjek pa shumë shpjegime. Mungesa e logjistikës së duhur të transportit publik bën që prindërit dhe fëmijët të hasin vështirësi dhe diskriminim nga pasagjerët apo shoferët.

**LNOB – faktori i cenueshmërisë:**
Periudha e pandemisë COVID-19 ka sjellë jo vetëm pasoja të rënda të shëndetit mendor, por edhe vështirësi të mëdha financiare dhe shpesh përkeqësim të shëndetit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Gjatë kësaj periudhe, asnjë nga familjet e këtij target grupi nuk ka përfituar pagesa ekstra financiare nga shteti.

**LNOB - faktori qeverisës:**
Pjesëmarrja në jetën shoqërore dhe politike në nivel lokal nga familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara është në shkallë shumë të ulët. Ata kurrë ose rrallë marrin pjesë në jetën shoqërore në nivel lokal dhe nuk mbështesin peticionet apo protestat civile. Për më tepër, si qytetarë ata janë mjaft pasivë në këtë drejtim dhe shumë shpesh nuk ndërmarrin asnjë veprim për mbrojtjen e interesave të tyre.
Për të vazhduar me arsyet e tjera pse ky target grup ka mbetur pas:

- 70% e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë kërkuar shërbimin e patronazhimit dhe theksojnë nevojën që kanë për këtë shërbim, dhe 53% e tyre kanë nevojë për ndihmë për fëmijën në familje.
- Mungesa e logjistikës në transport;
- Mungesa e vlerësuar e të ardhurave financiare;
- Diskriminimi, janë probleme të tjera me të cilat përballet ky target grup.

Në vijim të analizës, më poshtë janë paraqitur në mënyrë të detajuar gjetjet kryesore, të shoqëruara me: Konkluzione dhe Rekomandime si dhe Rekomandime në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

Për të rezultuar në një analizë sociale më të saktë dhe më të detajuar, janë realizuar edhe 126 intervista me prindër/kujdestarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në 10 njësi administrative rurale dhe 5 urbane të bashkisë Lushnjë. Pyetësori i zhvilluar u nda në 5 kategori si faktor

rreziku: Statusi social-ekonomik; Gjeografia; Qeverisja; Diskriminimi; Cenueshmëria ndaj situatave emergjente.

## 7.3. Statusi socio-ekonomik

### 7.3.1. Punësimi demografik

Shumica e pjesëmarrësve që ishin pjesë e anketës kanë pohuar se jetojnë në zona urbane. Sipas grafikut nr. 1, 47.6% e tyre jetojnë në zona urbane, përkatësisht vendbanime me më shumë se 500 banorë). 38,9% e të intervistuarve jetojnë në fshatra me një numër deri në 500 banorë, dhe 13,5% jetojnë në vendbanime me disa shtëpi (deri në 100 banorë).

61.1% e fëmijëve me aftësi të kufizuara, prindërit e të cilëve u intervistuan ishin djem dhe 38.9% prej tyre ishin vajza.




Nga totali i të intervistuarve përqindja më e lartë (80.2%) i përket grupit të çifteve të martuara (prindërit jetojnë së bashku dhe janë të martuar) me një diferencë të madhe me kategorinë tjetër, prindërit e të cilëve jetojnë në një lidhje (bashkësi jashtëmartesore) prej rreth 0.8%.




Rreth 7,9% e të intervistuarve i përgjigjen kategorisë së të pamartuarve që flet për një numër të konsiderueshëm vajzash të pamartuara që janë bërë nëna. 4% e të intervistuarve kanë pranuar se jetojnë me njërin prind për shkak të vdekjes së prindit tjetër. Rreth 5.6% e të intervistuarve jetojnë me prindër të divorcuar, ndërsa 1.6% nuk pranon t'i përgjigjet kësaj pyetjeje.




### 7.3.2. Të ardhurat

Të ardhurat ekonomike të familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara janë shumë të ulëta. Kjo nuk bën dallim nga zonat urbane apo rurale. Në shumicën e rasteve janë nënat ato që kujdesen për fëmijët, duke i penguar kështu që të punojnë. Gjithashtu, ndihma financiare PAK që ata marrin nga shteti për aftësinë e kufizuar të fëmijëve është mjaft e ulët dhe nuk plotëson kërkesat që ka ky target grup. Më poshtë janë paraqitur në grafikë disa nga gjetjet e këtij Hartëzimi Social.

Nga grafiku i mëposhtëm shihet përqindja më e madhe (50%) e të intervistuarve të cilët janë përfitues të ndihmës financiare nga shteti (pensioni social për shkak të aftësisë së kufizuar). Kjo shifër pasohet nga 18.3% që janë të punësuar, gjë që tregon një hendek të madh mes atyre që jetojnë me ndihmën PAK dhe janë shumicë në krahasim me ata që janë të punësuar. Ajo që përbën problem është fakti se 13.5% e prindërve të këtyre fëmijëve janë të papunë dhe nuk janë të regjistruar në Zyrën lokale të punës nëse krahasohet me një numër më të ulët të atyre që janë të papunë, por të paktën janë të regjistruar dhe shpresojnë të gjejnë një vend pune të referuar nga Zyra e Punës. Është një përqindje prej 5.6% që ushtrojnë të drejtën e ndihmës financiare nga mbrojtja sociale dhe rreth 4.8% refuzojnë të përgjigjen, ndoshta duke punuar në tregun e zi.




64% e të anketuarve kanë deklaruar se përfitojnë nga e drejta sociale për ndihmë; 45.2% nga puna e njërit prej prindërve, dhe 1.6% për shkak të pensionit.
Lidhur me mbështetjen financiare nga të tjerët, shumica e të intervistuarve i janë përgjigjur negativisht kësaj pyetjeje në përgjithësi, por kur analizojmë në mesin e atyre që janë përgjigjur pozitivisht, shohim se vetëm 54% kanë marrë mbështetje financiare nga burri/gruaja dhe 31.7% kanë marrë mbështetje nga shteti.




Shifrat janë më të ulëta për kategoritë e tjera si marrja e mbështetjes financiare nga vëllezërit e motrat ose fëmijët në rreth 9.5%. Besimi tek të afërmit është akoma më pak në rreth 4% dhe ndihma nga kishat (apo organizata të tjera fetare) 3,2% dhe kjo shifër është akoma më e vogël për miqtë dhe fqinjët deri në 2,4%. Ka një shifër prej 15.1% që refuzojnë ti përgjigjen kësaj pyetje.




Grafiku nr.7 tregon një përqindje të barabartë të të anketuarve që pretendojnë se kanë të ardhura mujore nga 10.000 deri në 20.000 lekë dhe ata nga 20.000 deri në 30.000 lekë, që flet për rreth 70% e të anketuarve që jetojnë me një pagë që është më e vogël sesa paga minimale ligjore në Shqipëri. 25.4. % e të anketuarve jetojnë me pagën mesatare prej 30.000 deri në 40.000 lekë dhe vetëm 15.1% marrin paga nga 40.000-50.000 lekë.




Nga përgjigjet e të anketuarve mund të vërehet një ndryshim i madh në mesin e atyre që nuk janë të kënaqur me buxhetin e tyre pasi 72,2 % pohojnë se buxheti i tyre nuk i plotëson nevojat e tyre bazë, ndërsa vetëm 25,4 % mund të plotësojnë nevojat e tyre bazë. Janë 2.4% e të intervistuarve që pretendojnë se bëjnë një jetë komode edhe pse buxheti i tyre nuk lejon kursimin e parave.

### 7.3.3. Kushtet e jetesës

Furnizimi me ujë është efikas në shumicën e familjeve pasi 92.9% nga të intervistuarit kanë pranuar se kanë pasur ujë të pijshëm të mjaftueshëm në muajin e fundit, megjithatë 7.1% e të anketuarve nuk kanë patur furnizim të rregullt me ujë.
Ndërkohë, nga grafiku i mëposhtëm është mjaft e qartë se 72.2% e të anketuarve të synuar kanë mundur të përballojnë gjithmonë një vakt në muajin e fundit, gjë që bie ndesh me 2.4% që nuk ishin aq me fat për shumicën e kohës duke iu referuar 4 e më shumë herë brenda

muajit të kaluar. 13.5% e të anketuarve kanë vuajtur nga uria disa herë (2-3 herë) dhe 7.1% nuk kanë mundur të përballojnë një vakt në muajin e fundit vetëm një herë. Por, vlen të theksohet se 4.8% e pjesëmarrësve në këtë anketim nuk pranuan të përgjigjen.




44,4% e të anketuarve kanë konfirmuar se zotërojnë një kompjuter ose pajisje tjetër në familjet e tyre si laptop ose tablet, ndërsa 55,6 % mohojnë të kenë ndonjë prej këtyre pajisjeve dhe kur janë pyetur për aksesin në internet për përdorim personal, vërejmë një përqindje të konsiderueshme të të intervistuarve që e dëshirojnë si shërbim por që pagesa është e vështirë të përballohet. Janë rreth 59.5% të familjarëve (më së shumti në zonat urbane) që kanë pohuar se kanë shërbim internet, edhe pse i kushtueshëm, e kanë të nevojshëm për fëmijët si edhe për t'u lidhur me familjarët jashtë vendit.



Ndërkohë 73% e të anketuarve pohojnë se kanë një televizor me kanale të disponueshme për moshën e fëmijëve të tyre, ndërsa nga ana tjetër 25.4% e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara dëshironin ta kishin një shërbim të tillë por nuk mund ta përballonin, ndërsa 1.6% pohuan se nuk kishin TV dhe nuk kishin nevojë për një pajisje të tillë.

Vlerësimi se sa para u nevojiten këtyre familjeve në muaj për të përballuar koston bazë të jetesës ishte shumë interesant për prindërit/kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara sepse tregon perceptime personale bazuar në nevojat. Kuptohet lehtësisht se në mesin e të anketuarve të synuar vetëm një përqindje e vogël për shuma të konsiderueshme parash, 0.8% thanë se do t'i duheshin rreth 150.000 lekë në muaj, ndërsa 27.8% thanë se do t'i duheshin 50,000 lekë si të ardhura mujore duke rritur kulmin e shumicës së të ardhurave të të anketuarve të cilët janë të kënaqur me këtë shumë parash. Siç shihet, ndryshueshmëria këtu është më e lartë. Buxheti mujor prej 25.000 lekësh për 2.4% paraqet ndryshime duke vazhduar të kërcejë nga njëra shifër në tjetrën.




Në grafikun nr. 11 është paraqitur statistika më e lartë për përgjigjet negative për të gjitha pyetjet. Kur u pyetën për mundësinë e punësimit të një personi që do të kujdeset për fëmijët ndërkohë që prindi është në punë ose nuk është në gjendje, 96.8% e tyre janë përgjigjur negativisht dhe vetëm 1.6% mund ta përballojnë këtë shërbim, e barabartë me 1.6% të tjerë që kanë refuzuar të përgjigjen, kjo sepse as nuk e kishin menduar ndonjëherë se mund të kishin një shërbim të tillë. Në vijim, për 92.1% të familjarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuar është krejt e pamundur të shkojnë me pushime për një javë jashtë shtëpisë, ndërkohë që vetëm 7.1% e të intervistuarve kanë pohuar se mund të përballojnë këtë shpenzim për fëmijën e tyre.




Rreth 89.7% e të intervistuarve nuk mund të përballojnë pagesën e shpenzimeve të papritura ose të nevojshme në shumën prej 300 deri në 500 euro, ndërsa 6.3% kanë mundësi që të përballojnë këto shpenzime, por 4% e të intervistuarve refuzuan të përgjigjen. Të pyetur për pagesat e hipotekës ose qirasë, faturat e shërbimeve, kështet e qirasë apo shlyerjet e tjera të kredisë, 81% e të intervistuarve rezultojnë të paaftë financiarisht për t'i përballuar ato, ndërsa 13.5% e këtyre familjeve mund t'i përballojnë.

Në vijim, 73% e të intervistuarve nuk kishin mundësi që në menunë e tyre të kishin mish ose ekuivalentin e tij vegjetarian në një kohë kur vetëm 22,2% mund ta përballojnë atë dhe 4,8% refuzuan të tregojnë nëse i kanë mundësitë për përdorimin e mishit në menunë e fëmijës apo jo. Ndërkohë që 54% e të intervistuarve pohojnë se nuk janë në gjendje të sigurojnë ngrohje që shtëpia të jetë me kushte optimale në krahasim me 45,2% të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar që mund ta përballojnë këtë lehtësi. Duket se blerja e barnave të përshkruara ose të nevojshme nga një pjesëtar tjetër i familjes është e rëndësishme për 54.8% të të intervistuarve të cilët kanë pohuar që mund t'i përballojnë shpenzimet e barnave, ndërsa 45.2% e të intervistuarve nuk kanë mundësinë financiare që ti përballojnë këto shpenzime.

Të pyetur për kënaqësinë në lidhje me kushtet e jetesës, vetëm 10.3% janë shprehur se janë të kënaqur dhe që kanë gjithçka që u nevojitet, ndërkohë 87.3% nuk janë pajtuar në këtë pikë dhe 2.4% kanë refuzuar të përgjigjen. Për opsionin e mungesës së kushteve të mira të jetesës për t'u kujdesur për fëmijën, 61,1% e të intervistuarve kanë pranuar se u mungojnë këto kushte. 69,8 % nga të intervistuarit janë pajtuar për opsionin e nevojës për ndihmë dhe kujdes professional duke e patur shumë të nevojshme për shëndetin e fëmijës, ndërsa 26,2% u shprehën se nuk kishin nevojë për ndihmë dhe kujdes profesional, ndërkohë që 4% kanë refuzuar t'i përgjigjen pyetjes. Zakonisht kjo kategori është e personave të cilët nuk kanë shumë informacion dhe për shkak të stigmës që ndjejnë, preferojnë të mos përgjigjen për shumë pyetje që janë të rëndësishme për analizimin e situatës së fëmijës së tyre.




Të pyetur për sfidat financiare që e kanë vështirësuar jetën e të anketuarve për pagesën e faturave si uji, energjia elektrike, telefoni, 27% e tyre janë shprehur se nuk kanë pasur kurrë sfida të tilla por 49,2% e të anketuarve kanë pranuar se kanë përballuar disa herë sfida në pagesën e këtyre faturave.

Riparimi i shtëpisë nuk ka qenë asnjëherë i vështirë për 17.5% të të intervistuarve, ndërsa ishte evidente se 45.2% ndonjëherë hasnin vështirësi, ndërsa 28.6% u përballën me një problem të tillë vetëm një herë.

Të pyetur për sfidat financiare për sigurimin e ushqimit, 58.7% pohuan se nuk kishin pasur kurrë probleme të tilla por 29.4% e të intervistuarve kanë pohuar se kanë pasur ndonjëherë probleme të tilla, ndërsa 7.1% e të cilëve e kishin hasur këtë problem vetëm një herë. Edhe për këtë pyetje kemi rreth 11% të të intervistuarve të cilët refuzuan të përgjigjen. Për sa i përket sfidave financiare për sigurimin e barnave për fëmijën, 48.4% pohuan se nuk e kanë përjetuar kurrë një sfidë të tillë, por 38.1% e tyre e kanë hasur ndonjëherë këtë vështirësi dhe 11.1% e kanë përjetuar vetëm një herë mungesën financiare për të blerë barnat e fëmijës.

## 7.4. Gjeografia – faktor risku

### 7.4.1. Rreziku dhe risku i izolimit për shkak të kushteve të jetesës

Të pyetur për llojin e vendbanimit të tyre, 41.3% e të intervistuarve pohuan se jetojnë në shtëpi në gjendje relativisht të mirë, e ndjekur nga një përqindje tjetër e lartë e tyre 15.1% që jetojnë në një apartament në një shtëpi familjare, ndërsa 14.3% e të anketuarve jetojnë në banesa me kushte të përshtatura jetese (me energji elektrike, ujë, tualet, telekomunikacion, etj.) 13.5% e të intervistuarve pohuan se jetojnë në shtëpi të vjetra në kushte të këqija, ndërsa 8.7% jetonin në apartament në një ndërtesë banimi në gjendje të keqe, pasuar nga 4.8% të cilët pretendonin se jetonin në apartament në një pallat banimi në gjendje relativisht të mirë. 2.4% e të anketuarve jetojnë në banesa pa kushte adekuate jetese.




77.8% e shtëpive të të anketuarve i plotësojnë kushtet elementare të jetesës, ndërsa 7.1% e shtëpive të të anketuarve nuk i plotësojnë kushtet elementare të jetesës dhe 13.5% e këtyre shtëpive i plotësojnë pjesërisht këto kushte.

Nga të gjithë të anketuarit, 54.8% jetojnë në katin përdhes që lehtëson lëvizjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, 20.6% jetojnë në katin e parë, 11.1% e tyre jetojnë në katin e dytë dhe 13.5% e të anketuarve thanë se jetojnë në katin e tretë ose më lart. Vetëm 8% e të anketuarve që jetojnë në katin e parë e lart pretendojnë se kanë ashensor.




Rreth 82% e të anketuarve thanë se në shtëpinë e tyre mungon qasja adekuate për fëmijët me aftësi të kufizuara, 15.9% pohuan se familjet e tyre ofrojnë qasje adekuate për fëmijët me aftësi të kufizuara, ndërsa 2.4% refuzojnë të përgjigjen. Për kategorinë e fundit në vizitën në shtëpi u vu re që shtëpitë nuk plotësonin as kushtet bazë për mundësimin e lëvizjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar.




Sipas grafikut nr. 15, një shifër e lartë prej 70.6% deklaruan se janë pronarë të shtëpive të tyre, ndërsa 1.6% deklaruan se banesa e tyre është ndërtuar në mënyrë të paligjshme, 11.9% jetojnë në shtëpi të personave të tjerë të panjohur për ta dhe 10.3% përdorin shtëpitë e të afërmve të tyre veçmas. Për të vijuar, 4% jetojnë në shtëpi kolektive.
Sipas anketës, shumica e të anketuarve kanë pranuar se kanë kushtet e nevojshme të jetesës si kuzhinë të inkorporuar në strukturën e shtëpisë e pohuar nga 77.8% e tyre, ujë të pijshëm dhe instalime hidraulike për rreth 87%, dush dhe tualet brenda shtëpisë në masën 81% dhe instalime elektrike në masën 95.8%. Ndërsa një përqindje e vogël e të intervistuarve thanë se u mungojnë këto kushte jetese dhe përkatësisht kuzhinë e inkorporuar në strukturën e shtëpisë 22.2%, ujë të pijshëm dhe instalime hidraulike 12.7%, dush dhe tualet brenda shtëpisë 19% dhe instalime elektrike 3.2%.

### 7.4.2. Vlerësimi i nevojave për fëmijët me aftësi të kufizuara

#### 7.4.2.1. Vlerësimi i nevojave bazuar në gjendjen shëndetësore

Shumica e të anketuarve kanë pasur nevojë për ekzaminime mjekësore në 12 muajt e fundit, 73,8% e tyre kanë pasur nevojë për ekzaminim të përgjithshëm mjekësor, ndërsa 48,4% kanë pasur nevojë për ekzaminim të specializuar, ndërsa në total 46% nuk kanë pasur nevojë për asnjë ekzaminim. 7.9% e të anketuarve pohojnë se kanë pasur nevojë për të dy llojet e ekzaminimeve por nuk kanë bërë një të tillë dhe 1.6% e të anketuarve kanë thënë se kanë pasur nevojë për të dyja llojet e ekzaminimeve disa herë, por fatkeqësisht nuk kanë marrë asnjë. Është i çuditshëm fakti se 12.7% e të anketuarve kanë refuzuar t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.




Kur të anketuarit e mësipërm u pyetën nëse i kishin marrë këto shërbime kur kishin nevojë, 87% e tyre e konfirmuan këtë fakt, ndërsa 12,7% pranojnë se nuk i kanë përfituar këto shërbime.

Sipas grafikut nr. 17 më poshtë, disponueshmëria e shërbimeve mjekësore dhe distanca nga vendi i banimit mund të përmblidhen në dy seksione:

- Së pari, institucionet/shërbimet mjekësore ekzistojnë në çdo bashki, në një distancë prej më shumë se 2 km. Përjashtim bëjnë ambulancat pasi sipas 80.2% të të anketuarve mund të gjenden në më pak se 2 km distancë.
- Së dyti, nga 7 nga 9 alternativa (pa përfshirë ambulancat dhe spitalet) grafiku i përgjigjeve tregon se ka përqindje shumë të vogla të të anketuarve që pretendojnë se shërbimet e këtyre institucioneve mjekësore nuk ekzistojnë.






Shërbimet e patronazhimit nga personeli mjekësor nuk ekzistojnë në Bashkinë e Lushnjës, por 23% e të intervistuarve pranojnë se kanë marrë shërbimin e patronazhit nga ofruesit shëndetësorë dhe 30,25% e tyre mohojnë të kenë marrë shërbime të tilla. Pothuajse gjysma e të intervistuarve 45.2% deklaruan se nuk kanë informacion se një shërbim i tillë ekziston. Në pyetjen se sa të kënaqur janë me këtë lloj mbështetjeje, 13.5% e të anketuarve janë shprehur se janë shumë të kënaqur, ndërsa 5.6% janë shprehur të kënaqur dhe rreth 4% janë shprehur se nuk janë të kënaqur me këtë lloj mbështetjeje. Kur të anketuarit u pyetën nëse kishin nevojë për këtë lloj shërbimi, 69.8% e tyre deklaruan se një shërbim i tillë do t'i ndihmonte.




Kur u pyetën nëse i marrin të gjitha shërbimet e nevojshme shëndetësore për fëmijën e tyre, 61% e të intervistuarve që janë prindër apo kujdestarë, pranuan se i marrin këto shërbime, në dallim nga 31,7% që deklaruan se nuk marrin një shërbim të tillë për fëmijën e tyre, që është një numër i konsiderueshëm i këtyre fëmijëve jashtë kujdesit të nevojshëm shëndetësor. Janë 7.1% e të intervistuarve që nuk e dinë përgjigjen e kësaj pyetjeje ose kanë refuzuar të përgjigjen.

Prindërit ose kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara u pyetën gjithashtu për pajisjet dhe mjetet ndihmëse që ata mendonin se do t'ua lehtësonin jetën fëmijëve të tyre. Përqindjet shumë të larta të të anketuarve pranojnë nevojën për të patur: matëse inteligjente të presionit të gjakut, puls, alarm për ilaçe (70.6%); një karrige me rrota tualeti (96%); karroca e zakonshme me rrota (93,7%); Karrige e papërshkueshme nga uji / karrige dushi (92.1%); një sistem personal për telefonatat urgjente për shërbimet mjekësore (84,1%); Syze leximi me xhama zmadhues (88.9%) ishin disa prej mjeteve që do të lehtësonin jetën e tyre dhe të fëmijëve të tyre.




Kur u pyetën nëse do të dëshironin që të mund të thërrisnin dikë për t'i ndihmuar me aktivitete të caktuara, pohimi ishte mjaft i lartë për rreth 74.6% e të intervistuarve që do të dëshironin të telefononin dikë për t'i ndihmuar në disa nga aktivitetet me fëmijët e tyre, ndërsa rreth 21.4% e refuzuan si ide, duke qenë se i kanë mbuluar vetë gjithmonë shërbimet për fëmijët dhe nuk e shikojnë komode të kenë dikë tjetër që mund të kujdeset për fëmijën e tyre.

Grafiku nr. 21 më poshtë është një grafik interesant, sepse tregon perceptimet personale, në një shkallë nga 1 deri në 5 ku 1 është rezultati më i ulët dhe 5 është rezultati më i lartë. Kënaqësia për marrëdhëniet ndërpersonale varion nga 31,7% në 9,5%, ndërsa ndjenja e braktisjes nga komuniteti varion nga 2,4% në 32,5% e pjesëmarrësve në këtë anketim. Siç shihet, ndryshueshmëria këtu është më e lartë. Numrat në vetvete mund të interpretohen si të ulëta në të moderuar dhe për rrjedhojë disi problematike. Pothuajse e njëjta ndryshueshmëri vlen edhe për pyetjet vijuese: Cili është niveli juaj i kënaqësisë me shërbimet sociale lokale dhe cili është niveli i kënaqësisë me shërbimet mjekësore lokale? E para varion nga 3.2% në 35.7%, ndërsa e fundit varion nga 2.4% në 32.5%. Në përgjithësi, mund të thuhet se të gjitha përgjigjet e lartpërmendura si grup priren të jenë më të larta, ose më të ulëta varësisht nga njësia administrative ku jetojnë të anketuarit.




### 7.4.2.2. Vlerësimi i nevojave për shërbim në shtëpi

Të anketuarve u janë bërë disa pyetje në lidhje me nevojat dhe aktivitetet ditore që kanë dhe kryejnë, d.m.th. nëse kanë nevojë për ndihmë për disa prej tyre.
Normat pozitive mund të shihen edhe në grafikun e mëposhtëm, i cili tregon këndvështrimin e prindërve nëse fëmijët e tyre kanë nevojë për aparat dëgjimi, gjë që 5.6% e kanë konfirmuar; nëse fëmijët e tyre kanë nevojë për ndihmë lëvizëse, gjë që e kanë konfirmuar 9.5%; nëse fëmijët e tyre kanë nevojë për një karrige me rrota, për të cilën 7.1% e kanë të nevojshme dhe nëse fëmijët e tyre kanë nevojë për ndihmë nga persona të tjerë ku 66.7% u përgjigjën pozitivisht për këtë nevojë.




Përgjigje të pritshme që nuk tregojnë të papritura vijnë nga grafiku i mëposhtëm. Sipas të anketuarve, fëmijët e tyre hasin në vështirësi më të mëdha se fëmijët e tjerë në kryerjen e veprimeve të ndryshme si higjiena personale, përgatitja e vaktit, ngrënia, lëvizja brenda dhe jashtë shtëpisë, përdorimi i mjediseve shkollore dhe transporti publik. Përgjigjet pohuese variojnë nga 37.3% (lëvizja brenda shtëpisë) në 81% (përdorimi i transportit publik). Ndërkohë, prindërit që thanë se fëmijët e tyre nuk kanë nevojë për ndihmë gjatë ngrënies

përfaqësojnë 42.9% të të anketuarve dhe ata që thanë se fëmijët e tyre nuk kanë nevojë për ndihmë për të lëvizur brenda shtëpive përfaqësojnë 62.7% të të anketuarve.




Në pyetjen se kush e ndihmon fëmijën në aktivitetet e përditshme, siç tregon edhe grafiku i mëposhtëm, prevalencën e merr nëna e fëmijës me 43.7% ndërsa babai merr vetëm 2.4% të




përgjigjeve. 13.5% e të anketuarve kanë deklaruar se nëna dhe babai së bashku ndihmojnë në aktivitetet e përditshme të fëmijës së tyre dhe kur e gjithë familja është e angazhuar kjo konfirmohet nga 14.3% e përgjigjeve. Një shifër e ulët prej 2.4% pranoi se gjyshja dhe nëna e fëmijës kujdesen për aktivitetet e përditshme. Prania e asistentit të dedikuar në këto aktivitete konfirmohet vetëm nga 13.5% e të anketuarve dhe 10.3% e tyre kanë deklaruar se prindërit së bashku me asistentët e dedikuar i ndihmojnë fëmijët në aktivitetet e tyre të përditshme.

Të anketuarit u pyetën gjithashtu për mënyrën dhe kohën e nevojshme për të shkuar në disa destinacione të ndryshme. Pothuajse gjysma e të anketuarve përdorin vetura për të shkuar te mjeku dhe në qendrat sociale, por kjo përqindje është më e ulët kur shkojnë në shkollë (33.3%) dhe në hapësira publike (30.2%). Duket se makinat familjare nuk mund të përdoren lirshëm për aktivitete të përditshme ose të zakonshme. Shumë pak të anketuar pranuan se ka njerëz të tjerë që i shoqërojnë në këto vende duke përdorur makinat e tyre (0.8% deri në 1.6%). Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve që variojnë nga 17.5% (qendra sociale) deri në 37.3% (mjekë); padyshim që nuk ka njerëz që nuk shkojnë fare te mjeku, por ka një përqindje të lartë (32.5%) që pranojnë se nuk frekuentojnë hapësirat publike si dhe përqindje relativisht të larta të të anketuarve që u kanë thënë fëmijëve të tyre të mos shkojnë në qendrat sociale (17,5%) ose në shkollë (16,7%). Mesatarisht të anketuarve u nevojiten nga 10,5 minuta deri në 28,8 minuta, por kjo distancë mund të jetë edhe 120 minuta në varësi të vendndodhjes specifike të të anketuarve.




Gjatë 12 muajve të fundit shumica e të anketuarve (61.1%) kanë marrë shërbime të punonjësve socialë, por përqindja e atyre që kanë akses në shërbime të tjera është mjaft e ulët. Ai varion nga 10.3% për asistencën për aktivitetet e përditshme në shtëpi deri në 37.3% për këshillimin/asistencën morale.

Kur u pyetën nëse shëndeti i tyre do të përkeqësohet seriozisht ose nëse kanë një shëndet të brishtë dhe nuk mund të kujdesen për fëmijët e tyre kujt do t'u kërkojnë ndihmë dhe mbështetje, rezultati më i dukshëm është përqindja shumë e lartë e të anketuarve (92,9%) që pretendojnë se në rast nevoje, familjet e tyre do t'u ofrojnë ndihmë. Kjo është një normë shumë e lartë, veçanërisht kur krahasohet me vetëm 21.4% që pranojnë se do të mbështeteshin në ndihmën e dikujt nga qendra sociale; 1.6% që do të thërrisnin një organizatë të shoqërisë civile dhe 6.3% që pranuan se do të asistoheshin nga Kryqi i Kuq. Edhe pse vetëm 0.8% thanë se nuk kanë ku të mbështeten si edhe fakti se shumica mbështetet tek familjet e tyre si më të besuarit, është e dukshme dhe kërkon adresim të menjëhershëm.

**Grafiku 26. Kërkesa për ndihmë në rastet kur nuk mund të kujdesemi per femijet**




Edhe kur janë pyetur nëse kanë me kë të flasin për problemet personale, në mënyrë të ngjashme, përgjigjet tregojnë se familjarët vazhdojnë të jenë burimi më i besueshëm i rehatisë, 93,7% e konfirmojnë këtë. Duhet shtuar se një përqindje e lartë mbështetet edhe në miqësinë e tyre (72.2%).

Të anketuarit u pyetën gjithashtu që nëse njerëzit që zakonisht i ndihmojnë nuk janë të disponueshëm, a do të donin që një person tjetër t'i ndihmonte kur mund të kenë nevojë për ndihmë. 62.7% e të anketuarve deklaruan se do të dëshironin të kishin dikë që t'i drejtoheshin për ndihmë, ndërsa 22.2% pohuan se mund të bënin gjithçka vetë. Një numër interesant i të intervistuarve, rreth 7.9%, thanë se do të prisnin që këta persona të ishin të disponueshëm, sepse nuk donin që njerëzit e tjerë t'i ndihmonin.

53.2% e të anketuarve kanë deklaruar se fëmija i tyre ka nevojë për kujdes në shtëpi dhe se do të donin që dikush ta vizitonte. Një tjetër 27% deklaruan se do të donin të kishin dikë që t'i drejtoheshin dhe 19.8% pohuan se nuk e kishin një nevojë të tillë.

Kur u pyetën që nëse do të kishin dhoma në dispozicion, a do ta ndanin ata banesën me një person që do të ndihmonte me fëmijën në kryerjen e aktiviteteve të përditshme, 29.4% e të anketuarve u përgjigjën negativisht, sepse nuk kanë nevojë për asistencë ditore, përveç në raste të caktuara. 32.5% e tyre thjesht nuk duan ta ndajnë banesën me persona të tjerë dhe 33.3% e të anketuarve do ta ndanin banesën me dikë që do të ndihmonte fëmijën e tyre.




Përgjigje shumë mbresëlënëse për shërbimet e kujdesit në shtëpi, gjë që flet për mungesën e shërbimeve të tilla si shërbimi rezidencial. Në pyetjen nëse prindërit apo kujdestarët marrin ndihmë dhe kujdes në shtëpi si shërbime sociale, 84,9% janë përgjigjur negativisht, ndërsa 15,1% janë përgjigjur pozitivisht, por sërish nuk janë në gjendje të ndajnë se cilat shërbime janë. Por të pyetur se kush i ofron këto shërbime, 3.2% e të anketuarve përmendin pagesën PAK për gjendjen shëndetësore të fëmijës si dhe shërbimin social shtetëror. Një 2.4% tjetër shkon në mënyrë të ngjashme me bashkinë dhe qendrën e zhvillimit që varet nga bashkia dhe shohim se vetëm 1.6% e të intervistuarve pretendojnë se këto shërbime ofrohen edhe nga punonjësit socialë.

Duke lexuar grafikun e mëposhtëm, është e qartë se shumica e të intervistuarve kanë pohuar se fëmija i tyre ose nuk merr shërbimin e asistencës personale (rreth 60.3%) ose nuk dinë për ekzistencën e saj (12.7%). 23,8% kanë deklaruar se fëmija i tyre merr një shërbim të tillë ndërsa 3,2 për qind kanë refuzuar të përgjigjen.




Të anketuarit që u përgjigjën pozitivisht për sa më sipër u pyetën gjithashtu se sa të kënaqur ishin me këtë lloj mbështetjeje. Përgjigjet për këtë pyetje fillojnë me 1 si më pak të kënaqur deri në 5 si më të kënaqur, kështu që bie në sy përqindja më e lartë e të intervistuarve që deklaruan se janë më pak të kënaqur me këtë lloj shërbimi dhe 31.7% gjejnë një mënyrë të mesme për të vlerësuar. Niveli i kënaqësisë në shërbim sheh rënie me një numër të konsiderueshëm të të anketuarve ku vetëm 6,3% e të anketuarve ishin shumë të kënaqur apo/dhe jashtëzakonisht të kënaqur me shërbimin.

Por nëse ndihma personale është e disponueshme, a do ta përdorin ata? Shumica e të anketuarve kanë pohuar përgjigjet e tyre me 61.9%, duke treguar kështu një nevojë të madhe për shërbimet e asistencës personale për këtë komunitet të synuar. Edhe pse 23.8% e të anketuarve kanë deklaruar se do ta përdornin këtë shërbim rrallë sepse disa nga aktivitetet i kryejnë vetë. Përgjigje negative për shërbimin vjen nga 6.3% ndërsa 7.9% kanë refuzuar të përgjigjen.

#### 7.4.2.3. Vlerësimi i nevojave për shërbime sociale në komunitetin lokal

Kur të intervistuarit pjesë e kësaj ankete u pyetën nëse fëmijët e tyre mund të vizitojnë një vend në bashki për një qëndrim afatshkurtër në një qendër ditore, shumica e të anketuarve 43,7% nuk e kanë idenë se ky shërbim ekziston ndërsa 42,1% janë në dijeni të Qendrës së Zhvillimit që lejon një qëndrim të shkurtër për fëmijët e tyre. Janë 4% e të intervistuarve që kanë një ide për qendra të tilla, por nuk dinë t'i adresojnë nevojat e tyre, por 10.3% e të anketuarve nuk kanë asnjë informacion.




Të pyetur për përdorimin e shërbimeve të qendrës së kujdesit ditor, 60.3% thanë se nuk e kanë përdorur, 29.4% janë pozitivë në përdorimin e këtij shërbimi ndërsa 10.3% refuzojnë të përgjigjen sepse nuk e dinë. Lidhur me kënaqësinë për këto shërbime ku 1 është nota më e ulët dhe 5 është shumë e kënaqur, vetëm 29.4% i janë përgjigjur kësaj pyetjeje. 3.2% e të anketuarve e kanë vlerësuar me 1 dhe 9.5% e tyre kanë vlerësuar maksimalisht 5, shumë të

kënaqur. Vlen të theksohet se 11.9% kanë një nivel përgjigjeje të mirë për këtë shërbim, duke e vlerësuar atë me notën 4.

**Grafiku 31. Ekzistenca e klubeve në bashki që ofrojnë shoqërim, argëtim dhe rekreacion për fëmijët me aftësi të kufizuara.**




Një tjetër pyetje interesante kishte të bënte me ekzistencën e klubeve në bashki, klube që ofrojnë shoqërim, argëtim dhe rekreacion për fëmijët me aftësi të kufizuara. Shumica e të anketuarve 70.6% janë shprehur se nuk kanë informacion nëse objekte të tilla ekzistojnë në bashkinë e tyre. 15.9% e tyre pranojnë se ka organizime dhe shoqata të tilla, ndërsa 6.3% mendojnë se ka objekte të tilla, por nuk dinë si të përfshihen. Është interesante sepse në fokus grupet e organizuara me prindër apo kujdestarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, apo me grupe të interesit, rezultoi se klube të tilla mungojnë. Kur u pyetën për përdorimin e shërbimeve të këtyre klubeve dhe shoqatave për fëmijët me aftësi të kufizuara, 73% e të anketuarve mohuan përdorimin e tyre, 13,5% kanë përdorur shërbime të tilla për fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara, ndërsa 13,5% refuzojnë të përgjigjen. Të anketuarit që kanë përdorur këto shërbime i vlerësojnë si të mira ose shumë të mira me 7.2%.

**Grafiku 32. Ekzistenca e mensës në bashki ku shërbehet dhe sillet ushqim për kategoritë vulnerabël të qytetarëve.**




Të anketuarit janë pyetur edhe për ekzistencën e ndonjë mense në bashki ku shërbehet ushqim për kategoritë vulnerabël të qytetarëve. 93,7% e të anketuarve nuk kanë informacion për ekzistencën e këtij shërbimi. 1.6% e të anketuarve mendojnë se ka një mensë të tillë por nuk dinë si të përfshihen dhe të përfitojnë nga ky shërbim, ndërsa 4.8% e tyre refuzojnë të përgjigjen.

Ndërsa 40.5% e të anketuarve kanë pranuar se do ta përdornin shërbimin e mensës së bashkisë nëse ekziston, por jo shumë shpesh, ndërsa 22.2% thanë se do ta përdornin mjaft shpesh. Një shifër e konsiderueshme prej 25.4% nuk do ta përdornin këtë shërbim, ndërsa 5.6 nuk e dinë nëse mund ta përdorin këtë shërbim. Të anketuarit u pyetën gjithashtu se si do të dëshironin që ky shërbim të ishte në dispozicion të tyre. Gjithsej 64,3 % i janë përgjigjur pyetjes, nga të cilët 34,9% do të donin të merrnin ushqim në shtëpi disa herë në muaj, 18,3% do të preferonin të shkonin vetë në kuzhinën ku shërbehet ushqimi.

Përsa i përket çështjes së transportit të organizuar drejt ambulancës, qendrave të kujdesit shëndetësor, apo klubeve/shoqatave të të moshuarve apo qendrave të tjera komunitare në bashki, 49.2% e të intervistuarve janë shprehur se nuk kanë një shërbim të tillë, 40.5% e tyre nuk kanë informacion për një shërbim të tillë dhe vetëm 6.3% e të anketuarve janë shprehur se kanë një shërbim të tillë, megjithëse është konfirmuar se transporti i organizuar nga bashkia mungon.




Kur u pyetën nëse kishin nevojë për një transport të organizuar për të shkuar në disa vende, përgjigjet treguan se në çdo rast më shumë se 50% e pohonin këtë. Pothuajse 70% e të anketuarve kanë nevojë për transport të organizuar për të shkuar në spital, rreth 60% e tyre kanë nevojë për këtë lloj transporti për të shkuar në qendrën ditore, pothuajse 60% e të anketuarve kanë nevojë për transport të organizuar për të shkuar te mjeku/ambulanca.




Grafiku më sipër tregon të gjitha përgjigjet e të anketuarve të përfshirë në këtë anketë.




Për të vijuar me anketimin, 38.1% e të anketuarve pohojnë për ekzistencën e institucioneve në bashki që ofrojnë kujdes ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara, ndërsa 34.1% nuk janë në dijeni për ekzistencën e tyre dhe 19.8% e tyre mendojnë se ka institucione të tilla. 5.6% e tyre thanë se nuk ka asnjë nga këto institucione që ofrojnë shërbime ndërsa 2.4% e tyre nuk pranuan të përgjigjen.
Të pyetur për emrin zyrtar të institucionit, 57.9% e të anketuarve i janë përgjigjur pyetjes nga të cilët 42.1% i janë referuar Qendrës së Zhvillimit për shërbime të tilla, 4.8% kanë emërtuar Shërbimin Social, 2.4% e tyre shohin qendrat për fëmijë që mund të ofrojnë shërbime të tilla, 4% e të anketuarve nuk kanë informacion të plotë për të dhe 2,4% e tyre nuk i dinë emrat e këtyre institucioneve.

Lidhur me sigurimin e kushteve adekuate për kujdestarinë dhe kujdesin ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara, pyetjes i janë përgjigjur rreth 57,9% e të anketuarve nga të cilët 38,1% kanë pohuar kushtet e mira, 8,7% janë shprehur se kushtet nuk janë të kënaqshme dhe 11.1% e tyre refuzuan të përgjigjen.
Nëse këto kushte do të ishin, 39.7% e të anketuarve i janë përgjigjur pyetjes për përdorimin e shërbimeve sociale, nga të cilët 23.8% kanë konfirmuar përdorimin e shërbimeve të tilla, 7.1% e të anketuarve kanë thënë se do t'i përdornin por vetëm nëse kanë nevojë për ndihmë. Rreth 1.6% e të anketuarve nuk dinë çfarë të thonë dhe nuk japin përgjigje.




Në lidhje me institucionin në bashki që ofron qëndrim të përkohshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara, 40.5% e të anketuarve mohojnë të kenë një informacion të tillë, 27% pranojnë se ekziston një institucion i tillë në bashkinë e tyre, ndërsa 15.9% e tyre mendojnë se ekziston një institucion i tillë, por nuk janë plotësisht të sigurt për të. 12.7% e të anketuarve kanë thënë se nuk ka një institucion të tillë në bashkinë e tyre dhe 4% e tyre kanë refuzuar të përgjigjen. Por, në fakt një qendër e tillë që ofron qëndrim të përkohshëm për fëmijët me aftësi të kufizuar mungon në bashkinë e Lushnjës. Të pyetur për emrin zyrtar të institucionit, 42,9% e

të anketuarve i janë përgjigjur pyetjes. Edhe pse nuk janë shumë të informuar për këto shërbime. 32.5% i janë referuar qendrave të zhvillimit për shërbime të tilla, 0.8% kanë emërtuar shërbimin social, 1.6% e tyre shohin qendra për fëmijë që mund të ofrojnë shërbime të tilla, 7.9% e tyre nuk i dinë emrat e këtyre institucioneve. Në vijim, 42,9% e të intervistuarve kanë dhënë perceptimin e tyre personal për përshtatshmërinë e institucioneve të tilla për qëndrim të përkohshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara, nga të cilët 34,1% kanë pohuar kushtet e mira, 3,2% e tyre janë shprehur se kushtet nuk janë të kënaqshme dhe 5,6% e tyre kanë refuzuar të përgjigjen. Kur u pyetën nëse "do të përdornin shërbimet sociale nëse disponoheshin" shumica, 20,6% konfirmuan se do ta përdornin, 18,3% deklaruan se do ta bënin këtë vetëm në rast nevoje, ndërsa 6,3% refuzuan të përgjigjen dhe pothuajse 8% deklaruan se nuk do ti përdornin këto shërbime.

Sipas grafikut më poshtë, është interesante se si 66.7% e të anketuarve pranojnë se nuk e kanë idenë nëse ka ndonjë institucion në bashki që ofron kujdes dhe mbështetje profesionale në lidhje me ushqimin, veshmbathjen dhe shëndetin në rast se fëmijës i mungojnë këto shërbime bazë në shtëpinë e tij. Një përqindje e vogël (6.3%) deklaruan se mendojnë se duhet të ketë një institucion të tillë; 7.1% pranojnë se ka një institucion që ofron kujdesin e lartpërmendur për fëmijët në nevojë, ndërsa 14.3% thonë se nuk ka një shërbim të tillë.

**Grafiku 36. Ekzistenca e institucionit në bashki që ofron përkujdesje dhe mbështetje profesionale për të ushqyer, veshmbathje dhe kujdes shëndetësor nëse një fëmijë nuk i ka kushtet për jetë të pavarur.**




Kur të anketuarit që janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen e mësipërme janë pyetur edhe për emrat e këtyre institucioneve, ka një konfuzion në përgjigje. 6.3% e të anketuarve mendojnë se Qendra për Zhvillim e cila ndodhet nën menaxhimin e bashkisë është institucioni që ofron shërbime të tilla; 2.4% nuk e dinë emrin e institucionit, ndërsa sipas mendimit të 4.8% të të anketuarve ekzistenca e këtij objekti i atribuohet OShC-ve të ndryshme por pa pasur informacion se cilat janë ato.




Shumica e të anketuarve (61.9%) nuk kanë asnjë informacion nëse ka ndonjë institucion në bashki që ofron një dhomë ndijore në të cilën nxënësit me aftësi të kufizuara do të mund të kalojnë një periudhë të caktuar të ditës, në rast se kanë vështirësi për të ndjekur procesin mësimor. 16% deklaruan se nuk ka dhoma të tilla, 10% besojnë se duhet të ketë një dhomë të tillë, por nuk janë plotësisht të sigurt, ndërsa 9% janë të sigurtë që ekziston një dhomë e tillë. 5% e të anketuarve besojnë se ekziston një qendër sociale që ofron një dhomë ndijore, ndërsa sipas mendimit të 14% të të anketuarve Qendra e Zhvillimit është ajo që ofron një dhomë të tillë.

Të anketuarit u pyetën gjithashtu nëse do t'i përdornin këto institucione nëse do të ekzistonin. 4% e tyre mohuan përdorimin e tyre të mundshëm; 44.4% do t'i përdornin pa hezitim; 21.4% do t'i përdornin ato vetëm në rast nevoje, ndërsa 7.9% refuzuan të përgjigjen.
Kur u pyetën nëse dikush u kishte kërkuar ndonjëherë kompensim për shërbimet e ofruara në institucionet e kujdesit për fëmijët me nevoja të veçanta: 73% deklaruan se askush nuk u kishte kërkuar para; 22.2% deklaruan se nuk i kishin përdorur kurrë këto shërbime; 0.8% janë shprehur se shërbimet nuk paguhen prej tyre dhe 4% kanë refuzuar të përgjigjen.

Sa i përket numrit aktiv të telefonit në bashki (linjë SOS) ku mund të telefonojnë nëse ndodh diçka, 16.7% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk ekziston një numër specifik telefoni në bashkinë Lushnjë ku njerëzit mund të telefonojnë në rast se ndodh diçka; 28,6% janë përgjigjur se nuk kanë nevojë për një numër të tillë; 4,8% pohuan ekzistencën e një numri specifik për raste të tilla urgjente dhe 50% nuk kishin informacion. Fakti është se në Bashkinë Lushnjë nuk ka një linjë të tillë SOS, por janë shpërndarë numrat personalë të stafit të Shërbimit Social dhe të Qendrës së Zhvillimit.



Kur të intervistuarit u pyetën nëse kishte akses adekuat në disa institucione për fëmijët me aftësi të kufizuara, në mënyrë të pavarur apo me mbështetjen e prindërve, 73% e të anketuarve konfirmuan se ka akses të duhur në spital dhe ambulancë dhe 68.3% pohojnë të njëjtën gjë për shkollat. Është interesante se pothuajse 47% e të anketuarve thonë se një qasje e tillë e duhur mungon në kopshte. Më shumë të dhëna janë paraqitur në grafikun nr. 42 më poshtë. Sidoqoftë, pjesa më e madhe e shkollave dhe një numër i konsiderueshëm institucionesh nuk ofrojnë logjistikë të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, sipas hulumtimit në terren dhe kontrollit të fakteve.




## 7.5. Vlerësimi i shërbimeve dhe institucioneve arsimore

Prindërit apo kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara janë pyetur edhe në lidhje me shërbimet arsimore për fëmijët e tyre. Gjatë 12 muajve të fundit shumica e fëmijëve kanë frekuentuar shkollat e përbashkëta me fëmijë të tjerë që nuk shfaqin nevojat e tyre (68.3%). Në mesin e fëmijëve të cilëve u është dhënë ndonjë formë edukimi, 40.5% janë ndihmuar nga një mësues për nevoja të veçanta të fëmijëve (mësues mbështetës). Vihet re se vetëm 19.8% e fëmijëve të të anketuarve kanë frekuentuar institucionet parashkollore dhe vetëm 23.8% e tyre shkojnë në qendra për fëmijë. Është mjaft e habitshme që vetëm 35.7% e këtyre fëmijëve asistohen nga psikologe edukative, edhe pse ky shërbim duhet të ofrohet me ligj.




Pothuajse gjysma e të anketuarve (47.6%) kanë deklaruar se në 12 muajt e fundit fëmijëve të tyre u janë siguruar shumica e nevojave arsimore që u nevojiten; 12.7% deklaruan se u janë ofruar të gjitha nevojat e tyre, por e njëjta përqindje vlen edhe për ata që mendojnë absolutisht të kundërtën, se nuk u është ofruar fare shërbim arsimor fëmijëve të tyre; dhe 23.8% janë përgjigjur se fëmijëve të tyre u janë ofruar vetëm disa shërbime arsimore.




Sipas 41% të të anketuarve brenda shkollave ka klasa/departament të veçantë për fëmijët me nevoja të veçanta; 37% kanë një mendim tjetër, se nuk ka klasa të tilla, ndërsa 22% nuk dinë ose refuzojnë të përgjigjen. Por, bazuar në fokus grupet e organizuara si me prindërit ashtu edhe me grupet e interesit, por edhe nga intervistat e thelluara, klasa të tilla nuk ekzistojnë në shkollat e bashkisë Lushnjë.

Ne u kemi kërkuar të anketuarve të listojnë shërbimet e mbështetjes arsimore për të cilat fëmijët e tyre kanë nevojë në nivel lokal. 22.2% e tyre, përqindja më e lartë deklaruan se fëmijët e tyre kanë nevojë për mësues për fëmijët me nevoja të veçanta; 15,1 % nuk kanë ndonjë mendim; 8.7% janë të kënaqur me shërbimet arsimore që merr fëmija i tyre, ndërsa 9.5% janë përgjigjur thjesht se fëmijët e tyre kanë nevojë për "shkollë". Ka edhe nevoja të tjera të shprehura në përqindje më të vogla si logopedi me 3.2%, 7.1% në klasë speciale; 2.4% për psikolog, etj.

Të pyetur nëse marrin ndonjë ndihmë të veçantë si prind/kujdestar i një fëmije me aftësi të kufizuara, 68.3% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk marrin ndonjë kompensim të veçantë

si prind/kujdestar i një fëmije me nevoja të veçanta; 31% deklaruan se e bëjnë këtë, ndërsa 0.8% nuk pranuan të përgjigjen.




Shumica dërrmuese e të anketuarve, 88% pranojnë se kurrë nuk u është kërkuar ndonjë pagesë për shërbimet arsimore që merr fëmija i tyre; 4% pranojnë të kundërtën, ndërsa 8% refuzojnë të përgjigjen.

## 7.6. Qeverisja – Faktor risku

### 7.6.1. Vlerësimi i pikëpamjeve dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara

Në lidhje me qeverisjen si faktor rreziku, ne u kemi bërë disa pyetje prindërve/kujdestarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Një nga pyetjet ishte edhe për politikën. Është një përqindje e lartë e të anketuarve që nuk ndjekin zhvillimet e fundit në vend (42.9%); 31.7% i ndjekin të paktën disa herë në javë; 23% e bëjnë këtë rrallë dhe 1.6% refuzon të përgjigjet.




Për sa i përket politikave të miratuara në nivel vendor në 3 vitet e fundit që janë në interes të prindit/kujdestarit të fëmijës me aftësi të kufizuara, 54% e të anketuarve nuk e dinë nëse në 3 vitet e fundit ka pasur politika në nivel vendor që i favorizojnë fëmijët e tyre, 29% janë të sigurtë se politika të tilla nuk miratohen, ndërsa 17% mendojnë të kundërtën.

Sipas grafikut më poshtë pak veprime janë ndërmarrë nga të anketuarit për të mbrojtur interesat e tyre. Shumica e tyre (58.7%) nuk i kanë kërkuar fare të drejtat e tyre. Megjithatë, disa kanë takuar deputetë të zonës së tyre (18.3%), ose anëtarë të këshillit bashkiak (19.8%). Disa prej tyre kanë takuar kryetarin e bashkisë (9.5%), apo kryetarin e këshillit bashkiak. Ata që kanë marrë pjesë në protesta të hapura bëjnë pjesë në një grup shumë të vogël (3.2%). Një grup akoma më i vogël, 0.8% përbëhet nga ata që kanë nënshkruar një peticion. Së fundi, përqindja e atyre që nuk kanë dhënë informacion për këtë pyetje është 11.9%.

**Grafiku 44. Veprimet e ndërmarra nga prindërit/kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të mbrojtur interesat e tyre**




Lidhur me besimin ndaj institucioneve, institucionet qendrore dhe vendore, përveç presidentit duket se gëzojnë një besueshmëri të lartë që varion nga 50% në 64.3%. Në fakt, këto deklarata janë kontradiktore pasi analiza e sipërpërmendur tregon se të anketuarit kanë marrë vetëm pak mbështetje dhe shërbime konkrete nga këto institucione! Gjithashtu, duhet theksuar se institucionet fetare janë institucionet e dyta më pak të besuara (23%). Edhe OSHC-të kanë në rastin më të mirë një besueshmëri të moderuar në mesin e këtyre qytetarëve (28.6%).

**Grafiku 45. Besimi ndaj institucioneve**




Gjithashtu pyetëm prindërit/kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara lidhur me prioritetet që duhet të ketë Bashkia Lushnjë. Gjëja më e rëndësishme për të anketuarit duket se është ndihma ndaj personave me nevoja të veçanta me 93.7% të të anketuarve. Mbrojtja shëndetësore duhet të jetë prioritet për 57.9%, ndihma ndaj njerëzve të varfër është

gjithashtu një çështje shqetësuese. 72% e të anketuarve e konsiderojnë atë si prioritet që bashkia duhet ta ketë në mënyrë absolute. Infrastruktura publike duhet të jetë prioritet i bashkisë për 50% të të anketuarve. Çështjet si mbrojtja e mjedisit apo uji i pijshëm konsiderohen më pak problematike dhe për këtë arsye vetëm 30.2% dhe 28.6% i shohin ato si prioritetet kryesore që duhet të ketë bashkia.

**Grafiku 46. Prioritetet që duhet të ketë bashkia**




Fakti interesant është se sipas 66% të të anketuarve nuk ka takime, nuk ka unitet midis prindërve/kujdestarëve të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe vetëm 31% pretendojnë se ka grupime të tilla. Gjithashtu, sipas prindërve/kujdestarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, 71% e të anketuarve nuk njohin dhe nuk janë në kontakt me asnjë organizatë që ndihmon personat me nevoja të veçanta dhe prindërit/kujdestarët e tyre; vetëm 15% kanë një njohuri të tillë. Siç mund të pritet, 60% e tyre nuk e dinë nëse ndonjë organizatë ka ndërmarrë ndonjë iniciativë për të mbrojtur apo avancuar të drejtat dhe nevojat e tyre në këshillin bashkiak; vetëm 7% kanë një mendim të ndryshëm, ndërsa 33% nuk e dinë dhe nuk kanë informacion për sa më sipër.

Është interesante dhe disi mbresëlënëse që shumica, 63% e të anketuarve nuk e dinë nëse ka ndonjë organizatë që përfaqëson personat me nevoja të veçanta në dëgjesa publike, debate, forume, takime me komunitetin lokal etj. Gjithashtu, 31% e të anketuarve janë të sigurtë se nuk ka organizata të tilla. Prandaj, vetëm 6% mendojnë se me të vërtetë ka organizata që përfaqësojnë interesat e tyre.

## 7.7. Diskriminimi – Faktor risku

### 7.7.1. Vlerësimi i përballjes me diskriminimin

Kemi pyetur prindërit/kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara nëse mendojnë se të drejtat e personave me aftësi të kufizuara respektohen në vend. 45% e të anketuarve mendojnë se të drejtat e personave me nevoja të veçanta nuk respektohen në vend; 43% thanë se nuk e dinë ose refuzuan të përgjigjen dhe vetëm 12% janë të kënaqur me mënyrën se si trajtohen njerëzit me nevoja të veçanta.




Megjithatë, 57% e të anketuarve kanë deklaruar se as ata dhe as fëmijët e tyre nuk janë ndier të diskriminuar gjatë 12 muajve të fundit. 15% refuzuan të përgjigjen dhe nuk dinin çfarë të thoshin; dhe vetëm 15% e pranuan se ka ndodhur kështu. Në fakt, kjo deklaratë nga anketa bie ndesh me fokus grupet e organizuara me prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ku diskriminimi ishte një nga problemet që ata hasnin në jetën e tyre të përditshme.

Të pyetur nëse janë ndier të diskriminuar nga institucione të ndryshme, një përqindje shumë e ulët e atyre që pranojnë se janë ndier të diskriminuar 2.4% deri në 5.6% është pothuajse e pabesueshme. Nëse jo për diçka tjetër, të paktën mund t'i atribuohet paragjykimit të dëshirueshmërisë sociale. Ndoshta pjesërisht është shprehje e dëshirës për t'u parë si i barabartë dhe i aftë.

Është problematike që edhe pse përgjigjet kanë këtë tendencë, përqindja është më e lartë e atyre që pranojnë se ndihen "ndonjëherë" të diskriminuar e kanë përjetuar këtë ndjesi në spital/ambulancë. Asnjë nga të anketuarit nuk ka raportuar ndonjëherë një akt diskriminimi.




### 7.7.2. Cenueshmëria – faktor risku – pandemia COVID 19

Pandemia rëndoi shumë në financat e të anketuarve. Gjithashtu, shumica prej tyre nuk dalin nga shtëpia si më parë (72.2%). Duke u ndier më të rrezikuar se të tjerët, ata kryesisht janë izoluar në shtëpi (73.8%). Shëndeti mendor vazhdon të jetë një çështje e diskutueshme, pasi përqindja e atyre që mendojnë se janë prekur mendërisht dhe emocionalisht nga pandemia (47.2%) është pothuajse e barabartë me ata që pretendojnë të kundërtën (49.2%).

**Grafiku 49. Ndikimi i virusit në aktivitetet e përditshme**




Të pyetur në lidhje me masat që janë marrë për parandalimin e përhapjes së koronavirusit dhe si kanë ndikuar këto masa, nga të anketuarit janë dhënë përgjigje kontradiktore. Shumica dërrmuese e të anketuarve kanë deklaruar se aktiviteti i tyre fizik dhe ai i fëmijëve të tyre nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim pavarësisht kufizimeve (81%). Vetëm 38.1% ndiheshin të vetmuar. E njëjta përqindje vlen edhe për ata që kishin frikë se do të infektoheshin, por ka shumë më tepër të anketuar (65.1%) që pranojnë se shëndeti i tyre dhe i fëmijëve të tyre ishte përkeqësuar. Pavarësisht qëndrimit të tyre optimist, vetëm 34.9% e të anketuarve besojnë se do të ketë një zgjidhje të suksesshme të situatës.
Ndërkohë në lidhje me kursimet, 87% e të anketuarve kanë pranuar se nuk kanë kursime që mund t'i përdorin për të zgjidhur problemet e shkaktuara nga pandemia e koronavirusit. Një përqindje e vogël, 7%, pranuan se kanë kursime dhe 6% refuzuan të përgjigjen.

**Grafiku 50. Kursime që mund t'i përdorni për të zgjidhur problemet e shkatuara nga situata e coronavirusit?**




Më shumë se gjysma e të anketuarve në njësi të ndryshme administrative, nga 53,2% në 92,9% pranuan se kanë marrë borxhe për të përballuar situatën e shkaktuar nga pandemia.

62% mohuan të kenë marrë ndihmë financiare për të përballuar koronavirusin. Pjesa tjetër kanë marrë ndihmë financiare por jo nga institucionet por nga familjarët.

Ndërkohë në vijim kemi një përgjigje tjetër kontradiktore në krahasim me ato të dhëna më sipër. 57% e të anketuarve pranojnë se kanë nevojë për ndihmë psikologjike në kohë pandemie. Në përputhje me përgjigjet e mëparshme të anketuarit kanë deklaruar se kanë nevojë për ndihmë financiare (86.5%). Shumë të anketuar dëshirojnë të kenë ndihmë në lidhje me barnat dhe vitaminat (41.3%). Është interesante se vetëm disa e konsiderojnë socializimin si të rëndësishëm (13.5%).

Në pyetjen se çfarë kanë nevojë më së shumti dhe çfarë duhet të mbulojë bashkia, 86.5% e të anketuarve kanë përmendur se mbështetja duhet të mbulojë përkatësisht: 41.3% ndihmë financiare të shtuar në shumën e pensionit mesatar, 31.7% kanë pohuar se do të kenë nevojë për kupona ushqimorë ndërsa 13.5 % kanë nevojë për lloje të tjera ndihme.

Koha e pandemisë ka ndikuar çdo të anketuar në shumë mënyra. Njerëzit ndihen të braktisur nga qeveria (65.1%), por kanë më shumë besim tek institucionet vendore. Edhe ky rezultat është në kundërshtim të hapur me të paktën një nga përgjigjet e mëparshme, sipas të cilës besueshmëria e qeverisë ishte 50%, ndërsa e institucioneve vendore 58%. Gjithashtu, është logjikisht e pashpjegueshme pse 47.6% e të anketuarve do të përgjigjeshin se të gjithë qytetarët kanë të njëjtat mundësi për të marrë shërbimet e nevojshme, kur mungesa e besimit në pushtetin qendror është kaq e lartë! Së treti, është e vështirë të shpjegohet fakti se vetëm 42,9% e të anketuarve pohojnë se si prindër të fëmijëve me nevoja të veçanta janë lënë në vështirësi kur shumica dërrmuese e tyre kanë deklaruar në përgjigjet e mëparshme se kishin nevojë për ndihmë financiare dhe psikologjike. Ajo që bie në sy është se brenda të njëjtit grafik, 60.3% janë përgjigjur se në fakt ata që janë më të arsimuar dhe që fitojnë më shumë të ardhura kanë më shumë mundësi për të qenë të sigurtë, për shkak të lidhjes së tyre me personelin e spitalit dhe njerëzit e tjerë ndikues.

## 8. Analizimi i Fokus Grupeve – Fëmijët me Aftësi të Kufizuar

Në bashkinë e Lushnjës u organizuan 4 fokus grupe me prindër/kujdestarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në përgjithësi, në të katër fokus grupet e organizuara, gjetjet dhe problemet e prindërve/kujdestarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të njëjta.

**Gjetje nga Fokus Grupi (FG) i parë:**
Fokus Grupi u organizua më 30 mars 2022 pranë Qendrës së Zhvillimit të Bashkisë Lushnjë, me pjesëmarrjen e 8 prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

- Në këtë FG morën pjesë prindër nga qyteti por edhe nga njësitë administrative rurale.
- Të gjithë prindërit pjesëmarrës vuajnë nga probleme ekonomike dhe sëmundja e fëmijës e ka vështirësuar situatën;
- 80% e pjesëmarrësve ishin të papunë dhe të paregjistruar në zyrën e punës;
- 100% e prindërve kanë marrë ndihmë financiare PAK nga shteti për fëmijën por nuk kanë marrë ndihmë financiare si kujdestar;

- Mungesa e logjistikës së duhur në transport e bën të vështirë lëvizjen me fëmijët; Kur duhet të udhëtojnë drejt Fierit apo Tiranës, kostot rriten më shumë dhe familjet nuk mund ta përballojnë atë;
- Gjatë periudhës së COVID-19 të gjithë reduktuan në mënyrë drastike lëvizjet e tyre, patën kriza shëndetësore të fëmijëve. Gjatë kësaj periudhe nuk kanë marrë ndihmë financiare shtesë nga shteti por pako ushqimore nga bashkia;
- Bashkia e Lushnjës nuk ofron transport të organizuar për këtë target grup, apo kompensim financiar, dhe shumë prindër herë pas here anashkalojnë vizitat mjekësore të fëmijëve kur ato duhet të kryheshin jashtë qytetit;
- Të gjithë prindërit pjesëmarrës i sjellin fëmijët e tyre në Qendrën e Zhvillimit, por sipas tyre koha në dispozicion nuk është e mjaftueshme;
- Mësuesit mbështetës në shkolla nuk janë shumë funksionalë.
- Psikologët shkollorë mungojnë ose edhe në rastet kur janë (psikologët) ata mbulojnë disa shkolla;

**Gjetje nga Fokus Grupi (FG) i dytë:**
Fokus Grupi u organizua më 30 mars 2022 pranë Qendrës së Zhvillimit të Bashkisë Lushnjë, me pjesëmarrjen e 9 prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

- Në këtë FG morën pjesë prindër nga qyteti dhe një pjesëmarrës nga njësia administrative rurale.
- Shumica e prindërve pjesëmarrës vuajnë nga probleme ekonomike dhe sëmundja e fëmijës e ka vështirësuar situatën;
- 60% e pjesëmarrësve ishin të papunë dhe të paregjistruar në zyrën e punës;
- 100% e prindërve kanë marrë ndihmë financiare PAK nga shteti për fëmijën por nuk kanë marrë ndihmë financiare si kujdestarë;
- Mungesa e logjistikës së duhur në transport e bën të vështirë lëvizjen me fëmijët;
- Kur duhet të udhëtojnë drejt Fierit apo Tiranës, kostot rriten më shumë dhe familjet nuk mund ta përballojnë atë;
- Prindërit kërkojnë të paktën një rimbursim nga bashkia për transportin me 5000 lekë në muaj;
- Gjatë periudhës së COVID-19 të gjithë reduktuan në mënyrë drastike lëvizjet e tyre, patën kriza shëndetësore të fëmijëve. Ata gjatë kësaj periudhe nuk kanë marrë ndihmë financiare shtesë nga shteti por pako ushqimore nga bashkia. Gjatë kësaj periudhe ata kanë kryer të gjitha vizitat mjekësore të fëmijëve të tyre në Fier ose në Tiranë.
- Bashkia e Lushnjës nuk ofron transport të organizuar për këtë target grup, apo kompensim financiar, dhe shumë prindër herë pas here anashkalonin vizitat mjekësore të fëmijëve kur ato ishin jashtë qytetit;
- Të gjithë prindërit pjesëmarrës kanë sjellë fëmijët e tyre në Qendër, por sipas tyre koha në dispozicion nuk është e mjaftueshme;
- Prindërit nuk janë të kënaqur me mësuesit mbështetës në shkolla.
- Prindërit ndihen shpesh të diskriminuar kur marrin shërbime mjekësore në Lushnjë;

- Prindërit me fëmijë 0-6 vjeç nuk mund t'i çojnë fëmijët në çerdhe ose kopsht sepse ligji nuk parashikon mësues apo edukatorë mbështetës dhe për këtë arsye ata janë të detyruar t'i mbajnë në shtëpi.
- Procedurat për përgatitjen e dosjes për asistencën e fëmijëve janë shumë të gjata dhe dokumentacioni i kërkuar shpesh është i pamundur të mblidhet;
- Prindërit kërkojnë ndryshimin e procedurës për miratimin e ndihmës financiare për kujdestarët (Asistent Personal) për të gjitha familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara.

**Gjetje nga Fokus Grupi (FG) i tretë:**
Fokus grupi u organizua më 1 prill 2022 pranë Njësisë Administrative Hysgjokaj të Bashkisë Lushnjë, me pjesëmarrjen e 8 prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

- Në këtë FG morën pjesë prindër nga njësitë administrative rurale.
- Të gjithë prindërit pjesëmarrës vuajnë nga probleme ekonomike dhe sëmundja e fëmijës e ka vështirësuar situatën;
- 100% e pjesëmarrësve ishin të papunë dhe të paregjistruar në zyrën e punës;
- 100% e prindërve kanë marrë ndihmë financiare PAK nga shteti për fëmijën por nuk kanë marrë ndihmë financiare si kujdestarë;
- Mungesa e logjistikës së duhur në transport e bën të vështirë lëvizjen me fëmijët;
- Gjatë Covid-19 nuk kanë marrë ndihmë shtesë financiare nga shteti por pako ushqimore nga bashkia.
- Bashkia Lushnjë nuk ofron transport të organizuar për këtë target grup, apo kompensim financiar, dhe shumë prindër shpesh anashkalonin vizitat mjekësore të fëmijëve kur ato ishin jashtë njësisë administrative;
- Duke qenë larg, rrallëherë i çojnë fëmijët në qendrën e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Lushnjë;
- Shumë prej tyre i kanë larguar fëmijët nga shkolla;
- Prindërit ndihen shumë shpesh të diskriminuar.
- Procedurat për përgatitjen e dosjes për asistencën e fëmijëve janë shumë të gjata dhe dokumentacioni i kërkuar shpesh është i pamundur të mblidhet.

**Gjetje nga Fokus Grupi (FG) i katërt:**
Fokus Grupi u organizua më 1 prill 2022 në orën 9:00 pranë Sallës së Këshillit Bashkiak të Bashkisë Lushnjë, me pjesëmarrjen e 8 prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

- Në këtë FGD morën pjesë prindër nga njësitë administrative rurale.
- Të gjithë prindërit pjesëmarrës vuajnë nga probleme ekonomike dhe sëmundja e fëmijës e ka vështirësuar situatën;
- 90% e pjesëmarrësve ishin të papunë dhe të paregjistruar në zyrën e punës;
- Shumë prindër kishin shumë pak informacion në lidhje me shërbimet e ofruara në bashkinë e Lushnjës për fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara.
- 100% e prindërve kanë marrë ndihmë financiare PAK nga shteti për fëmijën por nuk kanë marrë ndihmë financiare si kujdestarë;
- Mungesa e logjistikës së duhur në transport e bën të vështirë lëvizjen me fëmijët;

- Gjatë Covid-19 nuk kanë marrë ndihmë shtesë financiare nga shteti por pako ushqimore nga bashkia.
- Bashkia Lushnjë nuk ofron transport të organizuar për këtë target grup, apo kompensim financiar, dhe shumë prindër shpesh anashkalonin vizitat mjekësore të fëmijëve kur ato ishin jashtë njësisë administrative;
- Duke qenë larg, rrallëherë i çojnë fëmijët në qendrën e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Lushnjë;
- Prindërit ndihen shumë shpesh të diskriminuar.
- Procedurat për përgatitjen e dosjes për kempin e fëmijëve janë shumë të gjata dhe dokumentacioni i kërkuar shpesh është i pamundur të mblidhet;

Si pjesë e mbledhjes së informacionit, GADC organizoi gjithashtu 1 diskutim në fokus grup me palët e interesuara. Në këtë FG morën pjesë përfaqësues të Shërbimit Social, Qendra e Zhvillimit për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara; Përfaqësues nga Arsimi, Shëndetësia dhe Organizatat e Shoqërisë Civile.

**Gjetjet kryesore:**
Fokus grupi me grupet e interesit u organizua më 30 mars 2022 në orën 9:00 pranë sallës së Këshillit Bashkiak të Bashkisë Lushnjë, me pjesëmarrjen e 9 personave.

- Qendra e Zhvillimit për fëmijët me aftësi të kufizuara ka një staf prej 19 personash, nga të cilët 12 janë të specializuar për të ofruar shërbime për këtë target grup dhe pjesa tjetër janë staf ndihmës. Edhe pse kapaciteti i kësaj qendre është 26 fëmijë, aktualisht në këtë qendër marrin shërbime 54 fëmijë, ndaj nevoja për buxhet dhe burime njerëzore është mjaft e madhe. Buxheti për vitin 2021 ishte 14,366,000 lekë;
- Infrastruktura e institucioneve arsimore për personat me aftësi të kufizuara mungon pjesërisht në bashkinë e Lushnjës;
- Nuk ofrohen shërbime të asistencës sociale personale për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Çdo shkollë ka mësues mbështetës për këtë target grup, zakonisht është mësues për 2 fëmijë dhe ndihma që i jep çdo fëmije është në një rend të caktuar gjatë ditës; Por, edhe pse ka mësues ndihmës, në shkollat e Lushnjës nuk ka klasa të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Ka mungesë totale shërbimesh për fëmijët me aftësi të kufizuara 16-18 vjeç.
- Nuk ka qendër rezidenciale për këtë target grup;
- Në bashki nuk ka transport të organizuar, kjo për shkak se fëmijët e këtij target grupi janë të ndarë në zona të ndryshme dhe është e pamundur të koordinohen mjetet e transportit;
- Në bashkinë e Lushnjës nuk ka asnjë institucion që ofron kujdes dhe mbështetje profesionale për ushqim, veshmbathje dhe kujdes shëndetësor nëse një fëmijë nuk ka kushtet për jetesë të pavarur;
- Bashkia nuk ka një numër telefoni SOS, por ka shpërndarë numrat personalë të specialistëve dhe punonjësve të Shërbimit Social ose Qendrës së Zhvillimit;
- Në bashkinë e Lushnjës nuk ka klube që ofrojnë socializim, argëtim apo rekreacion për këtë target grup;
- Numri i psikologëve në shkolla është i ulët, me 1 psikolog për 700 nxënës.

## 9. Përfundime dhe rekomandime

Gjatë hartimit të këtij Hartëzimi Social, ne arritëm të evidentojmë edhe një herë nevojat që ka ky target grup. Familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë probleme të mëdha financiare, të cilat shpesh ndikojnë në marrjen e shërbimeve mjekësore apo shërbimeve të specializuara për fëmijët. Kjo është veçanërisht e vështirë për fëmijët me aftësi të kufizuara në zonat rurale. Në shumicën e familjeve që kanë një fëmijë me këto nevoja, njëri nga prindërit është gjithmonë i papunë dhe i detyruar të qëndrojë në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijën. Shërbimet sociale, edhe pse të pranishme në këtë bashki, ende nuk i plotësojnë të gjitha nevojat ditore të këtij target grupi apo ofrojnë shërbime rezidenciale. Të rinjtë me aftësi të kufizuara 16-18 vjeç nuk mund të marrin shërbime në Qendrën e Zhvillimit për këtë target grup.

Mungon kujdesi i specializuar mjekësor, duke rritur kështu jo vetëm rrezikun e përkeqësimit të shëndetit të fëmijëve, por edhe koston e udhëtimit në bashkitë e tjera për të marrë shërbimin. Asnjë nga mjetet e transportit, publik apo privat, nuk plotëson kushtet minimale të nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ndihma financiare që ky target grup merr nga shteti në shumë raste nuk mbulon as nevojat elementare të fëmijëve, duke sjellë kështu mangësi të theksuara.

Cilësia e asistencës së ofruar nga mësuesit mbështetës nuk është në të gjitha rastet në nivelin e duhur. Si dhe kjo ndihmë shpesh mungon sidomos në njësitë administrative urbane, pasi numri i tyre është më i ulët se nevoja e fëmijëve dhe numri i tyre.

**Rekomandimet kryesore:**

- Bashkia në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Arsimit duhet të identifikojë numrin e mësuesve ndihmës dhe të sigurojë që çdo fëmijë me aftësi të kufizuara të marrë asistencë ditore dhe sipas programit arsimor.
- Bashkia e Lushnjës duhet të sigurojë një buxhet që do të mbulojë transportin e organizuar të fëmijëve që duhet të marrin shërbime të specializuara jashtë qendrave të tyre rezidenciale.
- Të ndërtohen sa më parë dhe urgjentisht rampat në ato shkolla ku mungojnë.
- Bashkia duhet të kontrollojë dhe të detyrojë operatorët e transportit publik që automjetet e tyre të plotësojnë kushtet logjistike për këtë kategori.
- Rishikimi i ligjit dhe njohja e viteve të shërbimit (të prindërve) për fëmijët për të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, përcaktimi i orarit të punës.
- Rishikimi i ligjit dhe ofrimi i ndihmës financiare si kujdestar për çdo prind që ka fëmijë me aftësi të kufizuara dhe qëndron në shtëpi për t'u kujdesur për ta.
- Rishikimi i ligjit për emërimin e ndihmës edukatoreve për fëmijët që duhet të ndjekin kopshtin.
- Prioritet për zgjidhjen e problemeve për ofrimin e shërbimeve për të rinjtë me aftësi të kufizuara të grupmoshës 16-18 vjeç.
- Sigurimi i arsimit në shtëpi për të gjithë fëmijët që nuk mund të ndjekin shkollën.

- Rimbursimi i të gjitha barnave për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe përfshirja në skemën e rimbursimit edhe e vitaminave.
- Të shqyrtohet mundësia e ngritjes së një kuzhine brenda territorit të bashkisë e cila ofron të paktën një vakt për fëmijët me aftësi të kufizuara që vuajnë nga varfëria ekstreme.
- Dhënia e ndihmës psikologjike për prindërit e njësive administrative rurale që vuajnë nga barra e paaftësisë së fëmijëve.
- Informimi i publikut të gjerë dhe kësaj kategorie në veçanti për të gjitha shërbimet që ofron bashkia në ndihmë të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Krijimi i numrit aktiv të telefonit në bashki (linja SOS) ku prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara mund të telefonojnë për nevoja të ndryshme.
- Ofrimi i shërbimit të patronazhimit për fëmijët me aftësi të kufizuara.

## 10.Rekomandime në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

| Identifikimi i problemit | OZHQ | Efekti (Mesatar; I Ulët; I lartë) | Synimi | Indikatori | Institucionet kryesore |
|---|---|---|---|---|---|
| Shumica e fëmijëve me aftësi të kufizuara, përveç paaftësisë që i shoqëron gjatë gjithë jetës, kanë edhe probleme të tjera shëndetësore që vijnë si pasojë. Mungesa e shërbimeve të specializuara mjekësore për aftësinë e kufizuar të tyre pranë qendrave rezidenciale e rëndon akoma më shumë situatën. (Paraqitur në % ose përshkrues në Raport) | **OZHQ 3:** Shëndeti i mirë dhe mirëqenie | I Lartë | **Synimi 3.8:** Deri në vitin 2030 arrihet një mbulim universal shëndetësor duke përfshirë mbrojtjen e rrezikut financiar, aksesin në shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor thelbësor dhe akses në barna dhe vaksina thelbësore të sigurta, efektive, cilësore dhe të përballueshme për të gjithë. | • Identifikimi i shërbimeve të specializuara mjekësore për të cilat kanë nevojë fëmijët me aftësi të kufizuara.<br>• Numri i shërbimeve të shtuara sa më sipër.<br>• Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë përfituar shërbime të specializuara mjekësore pranë qendrave rezidenciale brenda bashkisë Lushnjë.<br>• Numri i fëmijëve që përfitojnë nga Qendrat Sociale apo të Zhvillimit | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Bashkia Lushnjë; Ministria e Financave dhe Ekonomisë. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Rekomandimi 1**: Ofrimi i shërbimeve të specializuara mjekësore pranë qendrave rezidenciale. | | | | |
| | **Rekomandimi 2:** Mbulimi i kostos në rastet kur këto shërbime duhet të merren jashtë bashkisë Lushnjë. | | | | |
| | **Rekomandimi 3:** Rritja e kapaciteteve të Qendrës së Zhvillimit Ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe ngritja e një qendre rezidenciale për fëmijët e këtij target grupi që vuajnë nga varfëria ekstreme. | | | | |
| Fëmijët me aftësi të kufizuara vuajnë mungesën e logjistikës së duhur për të hyrë në shkolla apo kopshte. Gjithashtu mungesa e numrit të mjaftueshëm të mësuesve ndihmës e vështirëson përparimin e tyre në shkollë dhe shpeshherë e braktisin arsimimin. | **OZHQ 4:** Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë dhe promovimi i të mësuarit gjatë gjithë jetës. | I lartë | **Synimi 4.1**: Deri në vitin 2030, të sigurohemi që të gjitha vajzat dhe djemtë të përfundojnë arsimin fillor dhe të mesëm falas, të barabartë | • Identifikimi i saktë i numrit të mësuesve mbështetës;<br>• Numri i mësuesve mbështetës dhe të specializuar për fëmijët me aftësi të kufizuara. | Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Drejtoria Arsimore Rajonale; 44 shkolla të |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Problematikë mbeten fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e njësive administrative rurale. | | | dhe cilësor që çon në rezultate të përshtatshme dhe efektive të të nxënit. **Synimi 4.a:** Ndërtimi dhe përmirësimi i objekteve arsimore që janë të ndjeshme ndaj fëmijëve, aftësisë së kufizuar dhe gjinisë dhe ofrojnë mjedise të sigurta, jo të dhunshme, përfshirëse dhe efektive për të gjithë. | • Numri i përfituesve që e marrin këtë shërbim në mënyrë të duhur dhe të pandërprerë.<br>• Numri i shkollave që plotësojnë kriteret logjistike për fëmijët me aftësi të kufizuara. | bashkisë Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë. |
| | **Rekomandimi 1:** Pajisja me logjistikën e duhur për aksesin në shkollë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ndërtimi i rampave në 28 shkolla të cilave u mungon kjo lehtësirë. | | | | |
| | **Rekomandimi 2:** Rishikimi i kurrikulës mbështetëse për këtë grup të synuar dhe vënia në dispozicion e mësuesve mbështetës për çdo | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | fëmijë me aftësi të kufizuara | | | | |
| | **Rekomandimi 3:** Rishikimi i ligjit për emërimin e ndihmës edukatoreve për fëmijët që duhet të ndjekin kopshtin | | | | |
| Familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë mungesa të theksuara të të ardhurave financiare. Meqenëse mungojnë shumë shërbime për fëmijët, në 99% të rasteve njëri nga prindërit detyrohet të qëndrojë në shtëpi si i papunë. Ndihma financiare PAK që marrin nga shteti për fëmijët është mjaft e ulët dhe nuk plotëson nevojat elementare. Gjithashtu numri i prindërve që marrin ndihmë financiare shtesë si kujdestarë është shumë i ulët. Në fund të fundit, edhe në rastet kur prindërit marrin ndihmë financiare nga shteti, vitet e shërbimit nuk njihen si vite pune për të gjitha kategoritë e këtij target grupi. Kështu mungon pagesa e kontributeve bazë shëndetësore dhe sociale. | **OZHQ 10**: Reduktimi i pabarazive | I lartë | **Synimi 10.1:** Deri në vitin 2030, të arrihet dhe të ruhet në mënyrë progresive rritja e të ardhurave të 40 përqindëshit të fundit të popullsisë me një normë më të lartë se mesatarja kombëtare<br>**Synimi 10.2:** Deri në vitin 2030, të arrihet fuqizimi dhe promovimi i përfshirjes sociale, ekonomike dhe politike të të gjithëve, pavarësisht nga mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, raca, përkatësia etnike, origjina, feja ose statusi ekonomik | • Numri i prindërve në grupin e synuar që do të marrin ndihmë financiare nga shteti për kujdesin e fëmijëve.<br>• Ndryshime në legjislacion në lidhje me tarifën mujore që përfiton ky target grup për shkak të aftësisë së kufizuar.<br>• Rishikimi i ligjit dhe njohja e viteve të shërbimit (të prindërve) për fëmijët për të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuar. | Komisioni Mjekësor për Caktimin e Aftësisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimeve Sociale; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Qeveria Shqiptare. |
| | **Rekomandimi 1:** Rishikimi i ligjit dhe | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | ofrimi i ndihmës financiare si kujdestar çdo prindi që ka fëmijë me aftësi të kufizuara dhe qëndron në shtëpi për t'u kujdesur për ta. | | ose ndonjë status tjetër. | | |
| | **Rekomandimi 2:** Rishikimi dhe rritja e ndihmës financiare për këtë grup të synuar. | | | | |
| | **Rekomandimi 3:** Rishikimi i ligjit dhe njohja e viteve të shërbimit (të prindërve) për fëmijët për të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuar. Gjithashtu përcaktimi i orarit të punës. | | | | |
| Mungesa e logjistikës në mjetet e transportit është një pengesë kryesore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Mungesa e shërbimeve pranë qendrave rezidenciale i detyron familjet e këtij target grupi | **OZHGJ 11:** Qytete dhe komunitete të qëndrueshme. | I lartë | **Synimi 11.2:** Deri në vitin 2030, të sigurohet akses në sisteme transporti të sigurta, të përballueshme, të | • Numri i operatorëve të linjës së transportit publik që plotësojnë kushtet e nevojshme për | Bashkia Lushnjë; Operatorët e transportit publik. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| të ndërmarrin udhëtime, shpesh të përditshme. Por, si transporti publik ashtu edhe ai privat nuk ofron kushtet e nevojshme për këta fëmijë. Gjithashtu bashkia e Lushnjës nuk ofron transport të organizuar për këtë target grup për lëvizjet për të marrë shërbime, duke rritur kështu kostot e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. | | | aksesueshme dhe të qëndrueshme për të gjithë, duke përmirësuar sigurinë rrugore, veçanërisht duke zgjeruar transportin publik, me vëmendje të veçantë për nevojat e atyre në situata të cenueshme, grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe personave të moshuar. | fëmijët me aftësi të kufizuara.<br>• Zëri i buxhetit për transport të organizuar nga bashkia.<br>• Numri i fëmijëve që përfitojnë nga transporti i organizuar nga bashkia | |
| | **Rekomandimi 1:** Detyrim nga bashkia që çdo operator transporti publik të plotësojë kushtet e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. | | | | |
| | **Rekomandimi 2:** Parashikimi në buxhetin vjetor të bashkisë Lushnjë i një fondi për mbulimin e transportit për këtë target grup, ose krijimi i transportit të organizuar sipas njësive administrative. | | | | |